

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7658 E premte 21 Shtator 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **i** Ditës

Një ndër thëniet më të famshme për të cilat mbahet mend Eleanor Roosevelt është shprehja se "mendjet e ndritura diskutojnë për ide, mendjet mesatare ..."
Vijon në faqen 20-21

Nga ADRI NURELLARI

Anti-thaçizmi si dëshmi e shterpësisë së mendimit politik në Kosovë



Opinion **i** Ditës

Eveja e një ish-agjenti të KGB-së, që u helmua me lëndë radioaktive në vitin 2006, thotë se përgjigja e menjëhershme mjekësore dhe diplomatike ...
Vijon në faqen 21

Nga "ZËRI I AMERIKËS"

E veja e ish-spiunit të vrarë: Metodatat e helmimit të Kremlinit



Zv.ndihmës-sekretarja e Shtetit, Elizabeth Millard

"Thaçi-Vuçiç po tregojnë se kanë imagjinatë" Zyrtarja e lartë e DASH-it: Veting në politikë? Çelësi janë SPAK-u dhe BKH-ja

Zv.ndihmës-sekretarja amerikane e Shtetit në "News 24": Reforma në drejtësi të vazhdojë

KLODIANA LALA

Zv.ndihmës-sekretarja e Shtetit, Elisabeth Millard zgjedh reformën në drejtësi si rrugën e vetme për të pastruar politikën nga krimi dhe korrupsioni. Gjatë një interviste për "News 24", zyrtarja e DASH thotë se SHBA-të ...
Në faqen 5

EMRAT/ 360 TRASHËGIMTARËT QË DO TË MARRIN DEMSHPERBLIMIN FINANCIAR

TE PERNDJEKURIT, KUSH E PERFITON KESTIN E DYTE

Ministria e Financave publikon listën e pasardhësve të ish-të dënuarve politikë që marrin paratë. 3 muaj afat për plotësimin e dokumenteve në dosje



(Në foto) Ish-të përndjekur politikë

1 MILION VENDE PUNE

Gjermania hap dyert për shqiptarët, Merkel: Lehtësim për procedurat

Në faqen 11

KALIMI I REFUGJATEVE

Korrupsion në kufi, arrestohen 6 efektivë policie në Kakavijë

Në faqen 9

3 TRANSFERIME

Dosja "Shullazi", Arta Marku ndëshkon prokurorët që refuzuan shortin

Në faqen 8

SHKODER

Abuzimet me ilaçet, arrestohet ish-drejtori i spitalit dhe gjashtë mjekë

Në faqen 10

BANKA E SHQIPERISE



Gubernatori Gent Sejko, mandat të plotë 7-vjeçar në Këshillin Mbikëqyrës
Në faqen 7

Kuvendi rihap garën për godinën e re. Opozita nga Vlora: Akt i paprecedent

Rama: Teatri karakatinë, do e bëjmë të ri

Kryeministri citon Rugovën në '92: Shkëmbim territoresh Kosovë-Serbi

Kryeministri Edi Rama u shpreh dje gjatë një interviste në "Opinion" të gazetarit Blendi Fevziu se është i vendosur për të shembur Teatrin Kombëtar dhe për të ndërtuar në vend të tij një të ri. Sipas Ramës, tetari është një godinë e marrë fund, "një varri hapur". I pyetur në lidhje me



kufirin Kosovë-Serbi dhe debatin e hapur këto ditë, Rama nuk dha një qëndrim të qartë, por tha se kjo është një dilemë dhe në të njëjtën kohë, një moment historik. Sot u rikthye debati i Teatrit, u duk se pati një tërheqje të mazhorancës. Jeni i vendosur...
Në faqet 2-4

TEATRI KOMBËTAR VOTIMI

Dy nismat e opozitës, kreu i PD: S'ka kompromis pa bërë vetingun e politikanëve

Basha akuzon Ramën: Hajdut, ligji për Teatrin, akt i paprecedent

"Marku të arrestonte hajdutët në Kuvend"

Valentina Madani

Opozita e bashkuar ishte dje në Vlorë në të njëjtën orë që zhvillohej seanca parlamentare. Në një kohë kur mazhoranca po votonte ligjin për Teatrin, opozita njoftoi dy nisma të rëndësishme, të cilat është e vendosur t'i realizojë me çdo kusht. Së pari, vetingun e politikanëve me votë të qytetarëve në rast se mazhoranca do ta refuzojë si dhe shpronësimin e kompanive që kanë bashkuar me qeverinë "Rama" për të fituar koncesione tendera korruptivë. Kreu i opozitës, Lulzim Basha, tha se me ju, qytetarë do të marrim vendimin final. "Zgjidhjet tona për lidhjet e krimit me politikën i keni të qarta, të dashur qytetarë! Me ose apo delet e Rilindjes dhe kriminelët e Rilindjes, dita do të vijë ku me votën tuaj. Ne do ta bëjmë vetingun në politikë realitet. Asnjë politikan i lidhur me krimin nuk do të ulët në institucionet e vendit".



Opozita e bashkuar dje në Vlorë

Dule e Mediu bojkotojnë takimin në Vlorë, Idrizi: S'erdhëm për të zhvendosur askënd

Në mbledhje e djeshme të opozitës në Vlorë munguan ish-kryeministri Sali Berisha, kreu i PR-së Fatmir Mediu dhe kreu i PBDNJ-së Vangjel Dule. Gjatë takimit, LSI dhe PD i uruan mirëseardhjen Shpëtim Idrizit të PDIU-së, i cili bëri të qartë se PDIU nuk i është bashkuar opozitës për të zhvendosur askënd. Sipas Idrizit, përballë një qeverie që e ka çuar Shqipërinë në drejtim të paditur, ka nevojë për një opozitë të fortë. Jemi të bindur se përballë një mazhorance arrogante që e ka çuar gjithë Shqipërinë në drejtim të paditur, ka nevojë për një opozitë të fortë. Dua të shpreh vlerësimin tonë për ju si deputetë, por edhe për kryetarët e partive opozitare për qëndresën dhe gjithçka keni bërë si opozitarë. Gjithashtu, më duhet të them shumë qartë se ne nuk kemi ardhur këtu për të zhvendosur kënd, por me respektin për çdo njërin nga ju dhe të gjitha partitë politike që e përbëjnë këtë opozitë të bashkuar. Ne besojmë se kemi ardhur këtu si vlerë e shtuar dhe për të ndarë bashkë prioritetet tona".

surive që kanë lidhur kontrata me Ramën dhe lukuninë e tij të hajdutëve. Sot po këtu do t'i japim formë përfundimtare platformës sonë për t'i dhënë zgjidhje drejtësisë dhe vendit zgjedhje të lira dhe të ndershme", theksoi z.Basha. Kreu i PD-së bëri të qartë se opozita nuk do të bëjë asnjë kompromis pa zgjidhur çështjen e largimit të politikanëve të lidhur me krimin. "Një Kuvend me kriminelë nuk është vendi për të kërkuar zgjidhje, por është vendi për të marrë fsheshën dhe për të pastruar, nuk do të ketë më asnjë ligj, reformë, pakt, negociatë, bisedë pa zgjedhur largimin e politikanëve të lidhur me krimin. Sekuestrimin e pa-

merituar shtetit të kapur nga krimi, duke filluar me çlirimin e Kuvendit. Naivëve dhe caqurleve të Ramës që pyesin pse PD dhe opozita nuk është në Kuvend u themi, teatri nuk është shkaku, por pasoja e emergjencës komplotare", theksoi z.Basha. Kreu i PD-së akuzoi kryeprokuroren Artur Marku, që sipas tij, shkoi në Kuvend për të legjitimuar vjedhjen që sipas Bashës po

VOTA E QYTETARËVE
Kreu i PD-së tha se qytetarë do të marrin vendimin final. "Zgjidhjet tona për lidhjet e krimit me politikën i keni të qarta, të dashur qytetarë. Me ose apo delet e Rilindjes dhe kriminelët e Rilindjes, dita do të vijë ku me votën tuaj. Ne do ta bëjmë vetingun në politikë realitet. Asnjë politikan i lidhur me krimin nuk do të ulët në institucionet e vendit".



Gjatë një seance parlamentare

DASHAMIR SHEHU

"Rruga është e gjatë dhe e vështirë. Opozita nuk është e lehtë. Na duhen të gjitha forcat, aq më tepër ata që kanë dëshirë të përzënë Edi Ramën dhe bandën që e kanë kapur. Nëse ky personazh është ulur këmbëkryq me hajdutët, jo se ne kemi qenë kristal të ndershëm, por si ky nuk kemi pasur", tha kreu i LZHK-së.

Vetingu, Kryemadhi: Nuk kemi më çfarë bashkëbisedimi të bëjmë me Ramën

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi paralajmëroi një aksion të fortë opozitar, duke lënë të kuptohej protesta. "Një aksion opozitar. Në takimet me qytetarët e kuptojmë që revolta, urrëjtja dhe mundësia për ta rrezuar janë shumë të mëdha. Ne kemi për detyrë që organizimin e partive tona ta përfshijmë dhe angazhojmë në aksionin politik të shqiptarëve", deklaroi Kryemadhi. Ajo mohoi të ketë negociata me kryeministrin, pasi sipas saj, më parë duhet të tregojë nëse është apo jo për vetingun e politikanëve. "Nuk kemi më çfarë bashkëbisedimi të bëjmë me Edi Ramën. Edi Rama të thotë nëse është po apo jo për çështjen e vetingut. Të ulemi, të kalojmë vetingun në politikë, sepse kjo është gjëja më e rëndësishme. Po u bëjmë veting dhe po i fusim në sitën e vetingut edhe edukatorët e kopshtëve dhe çerdheve dhe nuk bën veting Edi Rama, që është i pari i këtij sistemi që duhet të votohet. Kështu që mund të flasim pafundësisht, por mendoj që të kalojmë pastaj në detaje të tjera, në mënyrë të tillë që të ecim më shpejt për të vazhduar edhe me axhendën", tha zj.Kryemadhi.

bëhet me ligjin për Teatrin Kombëtar: "Në sallën e Kuvendit një mazhorancë e inkriminuar po ndërmerr një akt të paprecedentë në historinë e Europës. Artur Marku është shërbëtorë e Ramës dhe jo prokurorë e republikës. Prania e kryeprokurores kukull e Ramës në Kuvend është certifikata e vjedhjes, nëse do të kishte shkuar me pranga dhe tërhiqte zvarrë një duzinë hajdutësh dhe poli-

tikanësh të lidhur me krimin në atë sallë që bashkë me pjesën tjetër të rilindësve dele që po bëhen gati për aktin e vjedhjes. Edi Rama dhe hajdutët dhe kriminelët e tij në parlament bashkë me një tuftë delesh u kapën flagrant në vjedhje, përmes një procedure të përshpejtuar për grabitjen e pronës publike që të ngrinin 7 kulla me një vlerë 200 milionë euro", deklaroi z.Basha.

Pack nga Shkodra: Nëse nuk ndëshkoni krimin, nuk ka BE

Ish-eurodeputetja, sot presidente e forumit të grave të partive popullore europiane, Doris Pack, zgjodhi Shkodrën si një nga qytetet e goditura së fundmi prej ngjarjeve të rënda, të jepte një mesazh të fortë për qeverinë. "Jam e shokuar nga situata e kriminalitetit në Shkodër. Janë 6 vrasje dhe dy të zhdukur. Diskutohet përshirja e policisë dhe e vetë ministrit. Nëse qeveria nuk arrin të kapë kriminelët, nuk meriton të futet në BE. Shqiptarët po ikin jo se nuk e duan vendin, por se nuk kanë siguri. Ka një lloj mafie këtu. S'mund ta imagjinoj se kjo ndodh në një vend që po hap negociatat. Unë e pëlqej Shqipërinë dhe dua të jetë pjesë e Europës. Dua qytetet, dua njerëzit dhe nuk i kuptoj ministrat që nuk flasin qartë dhe hapur. Qeveria nuk po merrret me sigurinë e njerëzve. Unë e dua këtu sepse dua t'i hap sytë e politikës. Dua prej tyre qeveritarëve mund të kenë ndjenja, kanë edhe vetë fëmijë. Dhe fëmijët nuk rrinë këtu nëse s'kanë siguri dhe punë. Shqiptarët nuk ikin se e urrejnë vendin, por nuk kanë punë, vetëm kanabis", deklaroi Pack.




Kuvendi rihap garën për ndërtimin e godinës së re, opozita e Majko mungojnë në seancë

'Teatri': Rama nxjerr shkresën e Bashës për privatizimin e "Metropol"

Kreu i PD-së: Shkresa të pavlera, Teatri është aty

Darina Tanushi

Mazhoranca miratoi dje në Kuvend pa praninë e opozitës dekretin e Presidentit Ilir Meta "Për kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 37/2018 "Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negociimin dhe lidhjen e kontratës me objekt: "Projektimin dhe realizimin e projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar". Me 75 vota deputetësh, ku kontribut dhanë edhe të larguarit nga PDIU, shumica i hapi rrugën garës për kompanitë që dëshirojnë të hyjnë në garën për ndërtimin e Teatrit të ri Kombëtar. Në momentin e votimit mungoi kryeministri Edi Rama, si dhe ministri i Shtetit, Pandeli Majko, qëndrimi i të cilit ishte i mjaft diskutuar për këtë çështje. Relatori i çështjes, Ilir Beqaj, tha në fjalën e tij se, "në pesë vite janë bërë hapa konkretë për mirësimin në drejtim të teatrove". Sipas Beqaj, projekti i sjellë nga Bashkia e Tiranës e maksimalizim shfrytëzimitin e pronës publike duke e zhvilluar atë me një teatër bashkëkohor: Kreu i Kuvendit, Gramoz Ruçi sqaroi opozitën, e cila kërkoi shtyrjen e diskutimit të këtij ligji një ditë më parë. "Opozita më ka nisur një kërkesë. Opozita e sotshme ka shqyrtuar dekretin e presidentit dikur dhe ka miratuar ligjin. Kështu ka vepruar kur ishte në pushtet vetë opozita. Precedentët e tyre janë përgjigja më e mirë. Para se të ankohe dhe të kërkojnë e të protestojnë, duhet të dinë rregulloren. Kjo ishte sa për sqarim", u shpreh Ruçi, ndërsa hodhi në votim ligjin.



KOKA E TAVO
 Dy deputetët e LSI-së, Vangjel Tvaroçi dhe Lefter Koka kanë qenë dje të pranishëm në sallën e Kuvendit, por jo për të votuar ligjin për Teatrin. Sipas sqarimit të dhënë nga vetë LSI, deputetët kanë qenë në sallë për arsye të rinovimit të mandatit.

EDUART SHALSI
 "Kur ishin në pushtet, në asnjë rast nuk diskutuan për Teatrin. Tani vrasin mendjen për Teatrin. Opozita të tërheqë në një debat banal. Kemi përballë një palë që nuk ka bërë asgjë. Shqetësimi ynë ka qenë që të bëjmë një teatër dinjitoz. Reagimet e tyre janë një farsë. Ishin 8 vite në pushtet dhe nuk investuan për Teatrin, as nuk e lypen një herë", tha Shalsi.

ULSI MANJA
 "Ka dy ditë që PD dhe LSI thonë që kemi shkelur ligjin. Ka precedentë të mëparshëm kur Kuvendi drejtohej nga Meta. Presidenti ka të drejtë ta kthejë ligjin vetëm një herë. S'kemi të bëjmë me një rast për herë të parë", tha kreu i Komisionit të Ligjeve në seancë.

"Po ra Teatri, bie Shqipëria, do ketë konfrontim fizik"

Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit: Nuk kemi frikë

Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit e cilësoi sërish dje Antikushtetues ligjin për Teatrin, të miratuar në parlament. Përmes një deklarate, ata shprehën se përpos përmbajtjes, procedura e përdorur për të amenduar një ligj të kthyer nga presidenti është antikushtetuese dhe jotransparente. "Përpjekja e tyre për të zgjidhur problemin e konkurrencës nëpërmjet një tjetër ligji special, tashmë i panevojshëm, që detyron këdo të arrijë një marrëveshje paraprake me firmën e përgjegjdhur më parë është një tallje edhe me shqetësimet e ngritura nga vetë Komisioni Evropian", vëren Aleanca që mbrojnë Teatrin. Ata bëjnë me dije se përpjekjet e tyre për ta ndaluar sërish këtë çmenduri ligjore e demokratike nuk do të rreshtin. Teksa është shprehur e gatshme të nisë edhe një proces për restaurimin e godinës falë kontributeve private, AMT shton se hapësira për diskutime dhe rrugë institucionale po ngushtohet gjithmonë e më shumë. "Miratimi i ligjit do të fuste Shqipërinë de jure dhe de facto nën një diktaturë, ku Kushtetuta dhe të drejtat që burojnë prej saj nuk kanë më vlerë as formalisht", thuhej në deklaratë. Sipas saj, nuk ka qenë dhe nuk mbetet qëllimi i saj konfrontimi fizik, por fatkeqësisht, "jemi gjithmonë e më të qartë që nga ana e qeverisë gjasat për një kthim mbrypa janë gjithmonë e më të vogla". AMT e cilëson "tragjedi historike që 28 vjet pas rënies së diktaturës, jemi rikthyer në një pikë të tillë. Është e pamajgjuenesshme që një grup intelektualësh, të burgosur dikur nga regjimi komunist, shprehën sot se janë të gatshëm të futen edhe një herë në burg në mbrojtje të Kushtetutës dhe të Teatrit. Por nëse është vërtet kështu, ne nuk i frikësohemi asaj". Në fund, Aleanca shprehet se mbetet e bindur në idenë se po ra Teatri, ka rënë dhe Shqipëria. "Ndaj më shumë se kurrë janë të bindur e të gatshëm ta mbrojnë Teatrin deri në fund!".

"SULMOHEN" AKTORET
 Persona të panjohur fyen dje pranë Teatrit Kombëtar aktorët e shquara Yllka Mujo dhe Eva Alikaj me fjalor vulgar. Sindikata e Artistëve të Skenës dhe Ekranit proteston ndaj çfarëdo cenimi të dinjitetit të cilito artist, pavarësisht shkakuarit dhe shkakut. Artistët, pavarësisht qëndrimeve të tyre publike, janë qytetarë dhe duhen respektuar si të tillë. Kushdo që fyen artistët nuk mund të paraqitet si mbrojtës i Teatrit

Balla akuzon Bashën: Luli merr 2 mld lekë nga oligarkët

Kryetari i grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla akuzoi dje kryetarin e PD-së, Lulzim Basha se paguhet me 2 mld lekë nga oligarkët, ata që siç tha, i sulmon natën e i ndihmon ditën për logari të kumatit të tij. Balla nga foltorja e Kuvendit e ftoi kryedemokratikun Lulzim Basha të ndalte kërcënimet dhe të jepte përgjigje për ato që mediat shkruajin për të. "Dua t'i them sot nga kjo foltoje njaft me kërcënime idioteske. Shumë mirë që ke filluar konsulta me publikun, por në media sot ka dalë një fakt shumë domethënës se si Basha paguhet me 2 mld lekë nga oligarkët dhe nuk jep asnjë përgjigje. Janë oligarkët që i sulmon natën dhe i ndihmon ditën për logari të kumatit të tij", iu drejtua Balla, Bashës. Duke u ndalur tek ligji i Teatrit të ri, Balla tha se Basha ka mundësi të fusë tashmë në garë edhe kompani të afërta me të. "Nëse ka pasur merak që ndonjë kompani afër tij të hyjë të konkurrojë, le të konkurrojë. Pala shtet hyn në interes të mbrojtjes publike, asnjë cm tokë publike nuk tjetërsohet të privati", u shpreh Balla.



ish-ministri i Ekonomisë, Florjan Mima i kishte dërguar një shkresë ku kërkonte privatizimin e Teatrit të Metropolit për logari të deputetit Astrit Veliaj. "Ajo që më nxori këtu është një shkresë, të cilën Florjan Mima, ministër i Ekonomisë ia dërgon Lulzim Bashës, kryetar i bashkisë e çfarë i kërkon? I kërkon privatizimin e Teatrit të Metropolit, në kllapa shënon Florjan Mima 'Teatri i Estradës' për logari të deputetit Astrit Veliaj. I vetmi aset kombëtar në dispozicion të Bashkisë së Tiranës, i transformuar nga një kafene e degraduar, në një Teatër të Metropolit para se Basha të shkonte në bashki, çohet për privatizim jo

për PPP, as për të ndërtuar një Teatër të ri të Metropolit në këmbim të kontributit të zotit Veliaj dhe në funksion dhe të një përfitimi legjitim të zotit Veliaj, pasi të investonte për teatrin e ri, por për t'u privatizuar për pallat", deklaroi Rama. Kryeministri tha se Estrada është domein ekskluziv i PD-së. "Jemi përpara një shembulli se sa hipokritë është bërtitja e tyre, sikur thonë se duan të mbrojnë Teatrin Kombëtar, një godinë e marrë fund, që vetëm Teatër nuk mund të jetë. Ndërkohë që e ka skenën 8 metra të gjërë, skena e Teatrit të Turbinës është 24 metra. Edhe sikur të merret hipoteza e restaurimit, që është e pamundur, sërish do kishim një skenë prej 8 metrash", theksoi Rama. I menjëhershëm ka qenë reagimi i kryedemokratit Basha, për kryeministrin Rama. Me një shënim në rrjetin social "Twitter", Basha i kujtoi Ramës se Teatri i Metropolit është ende aty dhe i numëron të gjitha kinematat që ka shkatërruar për të ndërtuar pallate. "Kryehajduti kërkon skutave për shkresa të pavlera. Teatri i Metropolit është aty. Kinema '17 Nëntorit', kinema 'Republikën', kinema 'Partizanin', kinema 'Ali Demin' i ka shkatërruar Rama dhe ka ndërtuar pallate", u shpreh Basha.

KRYEMINISTRI INTERVISTA

Kryeministri: Çështja nuk avancoon duke u sjellë si qafirë me njëri-tjetrin

Kufiri Kosovë-Serbi, Rama: Dilemë, por moment historik

"Teatri, varr i hapur, s'kemi luksin të mbajmë karakteratina"

Kryeministri Edi Rama u shpreh dje gjatë një interviste në "Opinion" të gazetaris Blendi Fevziu se është i vendosur për të shembur Teatrin Kombëtar dhe për të ndërtuar në vend të tij një të ri. Sipas Ramës, tetari është një godinë e marrë fund, "një varr i hapur". I pyetur në lidhje me kufirin Kosovë-Serbi dhe debatin e hapur këto ditë, Rama nuk dha një qëndrim të qartë, por tha se kjo është një dilemë dhe në të njëjtën kohë, një moment historik.

Sot u rikthye debati i Teatrit, u duk se pati një tërheqje të mazhorancës. Jeni i vendosur për të shembur Teatrin aktual?

Nuk është lënë, por është marrë kohë, pasi ka pasur edhe një adresim të Komisionit Evropian. Është marrë edhe mendimi i KE-së, i qartë plotësisht lidhur me faktin se nisim nuk bie ndesh me asgjë evropiane, me asnjë standard.

BE dhe SHBA kanë kritikuar faktin se nuk ka pasur garë...

Me sugjerimin që të futet elementi i ofertës edhe për të tjerët, edhe pse në rastin konkret, fakti që ka pasur një nisim për një ligj të posaçëm me një kompani të përcaktuar nuk është aspak e re në kornizën e Evropës. Sillovakia, që është një nga vendet me investime ka kaluar rreth 150 ligje të posaçme. Ligj të posaçëm me emër e mbiemër ka kaluar edhe shumica e mëparshme.

Pse nuk e restauroni me të njëjtin projekt?

Skena e kësaj godine është 8 metra e gjërë. Është skenë për vatër kulturore, jo skenë teatri bashkiak. 24 metra e gjërë është skena e "Turbinës". E dyta ka funksionuar nën logon e Teatrit Kombëtar, por ka qenë jashtë të gjitha standardeve të një teatri normal. Është një godinë ku nuk fton dot një trupë të huaj. Është një godinë ku të gjithë që kanë dhënë jetën për atë kanë sakrifikuar për të luajtur. I ka ardhur fundi prej kohësh. Nuk ka asgjë që ajo godinë të mund të qëndrojë atje si varr i hapur.

6 kulla ku do bëhen?

A mund të më numëroni në Tiranë? 1 kullë e gjysmë ka në Tiranë prej 20 viteve.



Kryeministri Edi Rama, dje gjatë një interviste në "Opinion"

Njëra është ndërtuar plotësisht dhe është godina e bukur që ka Tirana dhe tjetra nuk po mbaron. Të dyja kullat që janë projektuar dhe ndërtuar nuk i gjen as në Dubai, as në Paris.

Të mos ketë histori Teatri Kombëtar...?

Historia e Teatrit Kombëtar nuk janë muret, janë aktorët, janë rolet. Në godinën e re do të ketë edhe një hapësirë muzeale, siç do ketë edhe në stadiumin kombëtar. Shqipëria nuk ka luksin të mbajë në këmbë karakteratina. Debati për korrigjimin e

isht dhe ka thënë se ai shikon një oportunitet për të mbyllur një epokë dhe ka folur për korrigjim kufijsh. Unë flas për çfarë ka më tutje. Pra, nuk kemi një produkt bashkëbisedimi mes Presidentit të Kosovës dhe Serbisë. Nuk mund të bëjë njeriun që rri larg. Kam bërë detyrat e mia dhe bëj përditë detyrat e mia.

A e kemi lehtësuar ju një komunikim mes Thaçit e Vuçiqit?

Nëse ka ndodhur më vjen shumë mirë, por nuk mendoj se kam ndonjë rol.

Çfarë qëndrimi keni ju?

QENDRIMI

Edhe Sali Berisha është komplet në pozicion të kundërt me Rexhep Qosjen, por nuk mund të them që është tradhtar. Është fatkeqësi e madhe kur sot faktorët vendimmarrës shqiptarë duhet të ndërtojnë proces dhe të diskutojnë me njëri-tjetrin.

kufijve Kosovë-Serbi, **a kemi biseduar me Presidentin Thaçi për debatin për kufijtë?**

Sigurisht që kam biseduar me presidentin. Nuk kam dënuar për asnjë lloj detaji. Presidenti ka folur publik

Edhe Sali Berisha është komplet në pozicion të kundërt me Rexhep Qosjen, por nuk mund të them që është tradhtar. Është fatkeqësi e madhe kur sot faktorët vendimmarrës shqiptarë duhet të ndërtojnë

proces dhe të diskutojnë me njëri-tjetrin.

Duhet ta udhëhiqni ju këtë?

Pusho, se nuk jam kryeministër i Kosovës unë. Në emër të Kosovës flasim të tjerë. Kosova është shtet i pavarur. Unë kam shumë respekt për Hashim Thaçin.

Ky është një moment historik, që nuk mund të këputet duke bërë politikën e qenve që lehin e kafshojnë njëri-tjetrin duke personalizuar historinë.

Çfarë mendimi keni ju?

Opinionim im është ky që unë nuk e kam përgjigjen. Unë mendoj që kjo nuk është një përgjigje që jepet kollaj. Ama di të them këtë: e para, dhe nuk e kam kritikë për Hashim Thaçin, unë mendoj që personalizimi i kësaj gjëje është një diçka që mund të ketë një kosto shumë të madhe.

Pse e quani një shans?

Shansi? Këtu janë disa



të blerë armë, ku janë njerëzit që bëjnë histori, të marrësh Saliun këtu, ai mund të tregojë përralla, por nuk mund të tregojë histori. Korrigjimi i kufijve nuk është qëllim, është mjet.

A keni folur ju me Presidentin Vuçiq, se ka thënë edhe ish-ministri Karl Bild?

Karl Bildi ka bërë një shkelje etike, që një ministri të Jashtëm, një suedez dhe një njeriu që është mik, nuk i takon ta bëjë. Karl Bildi ka biseduar me mua dhe unë kam thënë gjërat që thashë këtu. Nëse juve ju duket se unë po them se e mbështes këtë gjë, atëherë është fajli im. Por, unë jam absolutisht i bin-

isha ka diçka për të dhënë. Nuk është kaq e thjeshtë kjo dhe nuk mund të ndahemi këtu në tradhtarë e patriotë. Ky nuk është Teatri Kombëtar. Kjo është historia e kombit shqiptar. Mund të jetë e gjitha një gjë që përfundon në asgjë. Por ne strategjikisht na duhet që në fund të procesit çështja e shqiptarëve të jetë më e avancuar. Çështja nuk avancoon duke u sjellë si qafirë me njëri-tjetrin dhe duke u sjellë me tifozllëk kush jam unë e kush je ti.

Je për një marrëveshje mes shqiptarëve e serbëve për shkëmbim terri-torësh?

Shumë e diskutueshme. Unë mendoj që qëllimi strategjik është "A". Instrumentet janë të diskutueshme. Dhe ata që marrin përsipër të thonë që kjo është tradhti kombëtare është një çmenduri. Ai pozicion të çon më mbrapa se të ka çuar dialogu. Kosova është shtet me vete dhe ka autoritetet e veta. Po të më lexoni mes rreshtave, unë kam rezervë për të gjithë aktorët, sepse janë "Klubi i Selanikut" të Çajupit. Si kryeministër i Shqipërisë, qëndrimi im është shumë i qartë, mbështetje Kosovës dhe autoritetet të saj sido që të vijë puna.

Duket sikur edhe me Ditmirin bëjmë debat për këtë çështje. Kjo kërkon shumë profesione, shumë mendje, shumë dashuri për këtë vend këtej e andej beshkëve. Kjo është një dilemë, por unë mendoj që është një moment historik.

Pse nuk pranoni propozimin e opozitës për vetëtimin?

Qëllimi i kësaj është që të ndërtohet një fabul, që unë s'kam frikë, ti ke frikë. Nuk është vetëtim ky, por është palaçollëk. Po prapë po them që do t'i japim një shans edhe këtij propozimi.

HISTORIA

Historia e Teatrit Kombëtar nuk janë muret, janë aktorët, janë rolet. Në godinën e re do të ketë edhe një hapësirë muzeale, siç do ketë edhe në stadiumin kombëtar. Shqipëria nuk ka luksin të mbajë në këmbë karakteratina.

faktorë me radhë. Rugova në atë kohë kur ka folur, ka folur duke menduar për Kosovën e pavarur, jo për të ndarë Kosovën me Millosheviçin. Por sot Kosova ka perspektivë të qartë? Sot Kosova ka 5 shtete të BE-së që nuk e njohin. Sot Kosova ka Serbinë të ulur brenda në parlament, në qeveri. Nuk bën dot asgjë pa marrë dorën e serbëve. Këtë ta dëgjojë edhe Ramushi e Hashimi. Kur ndërmoren atë nisim që bëri histori dhe që nuk pyetën fare as për gazetaret, as për ndërkombëtarë dhe që morën edhe damkën e terroristeve, shkuan në Amerikë, krijuan lidhje dhe kanë marrë mbështetje shumë të madhe nga diaspora shqiptare e Amerikës. Tani pse nuk shkojnë ta marrin mendimin e diasporës? Të gjithë ata kontributorët të pavarësisë së Kosovës që lanë pasurinë për

dur që ne duhet të jemi shumë të hapur dhe të matur për të gjitha opsionet dhe të vlerësojmë peshën historike që ka ky moment. Kjo është çështje zgjedhjeje. Siç është kështu, Kosova nuk mund të garantojë perspektivën e atyre që sot janë 18 vjeç. Me Vuçiqin unë kam folur dhe flas, kemi rëndë dakord që të mos jemi dakord në këtë pikë. Bindja ime është që sa më shpejt ata të heqin dorë nga Kosova, aq më mirë është. Vuçiqi është Presidenti i Serbisë, nuk punon as për mua, as për ty, as për Ramushin, as për Thaçin. Si mund t'i thuhet Hashim Thaçit "je argat i Beogradit". Që këtu debati bie. Ju e dini se sa e dua unë Saliun. Por kurrë në këtë fazë s'mund t'i them unë Saliut çove naftën, s'cove naftën, i ka bërë ai të gjitha, por në këtë proces edhe Sali Ber-



"Drejtesia", zyrtarja e DASH flet për "News 24": Punoni së bashku, presim rezultate konkrete

DASH, Millard: Vetingu në politikë? Çelësi, SPAK e BKH

"Shqipëria po përparon në shumë fusha"

Klodiana Lala

Zv.ndihmës Sekretarja e Shtetit, Elisabeth Millard zgjedh reformën në drejtësi si rrugën e vetme për të pastruar politikën nga krimi dhe korrupsioni. Gjatë një interviste për "News 24", zyrtarja e DASH thotë se SHBA-të presin rezultate konkrete, duke përcaktuar SPAK dhe BKH si institucionet kyçe të kësaj reforme. E pyetur për vetingun në politikë, propozimin më të ri të opozitës, Millard këmbënguli se, "çelësi është SPAK dhe BKH". Duke folur për "korrigjimin e kufijve" mes Kosovës dhe Serbisë, Millard u shpreh se SHBA shpreson se rezultatet e bisedimeve mes dy liderëve do të jenë një gjë e mirë për Ballkanin.



Zv.ndihmës Sekretarja e Shtetit, Elisabeth Millard

VETINGU
"Është gjithnjë mirë të shihet se çfarë mund të bëhet dhe rëndësishëm për opozitën dhe qeverinë që të punojnë për të parë se çfarë mund të bëhet tjetër, por mendoj se çelësi është ngritja dhe funksionimi i këtyre institucioneve të rëndësishme. Mendoj se ky duhet të jetë fokusi në këtë moment", - tha zj. Elisabeth Millard.

Takimi me Metën, Mustafa: Ndryshimi i kufijve, i rrezikshëm e i papranueshëm

Presidenti Ilir Meta mori pjesë dje në përrurimin e shtatore në Drenas të Kosovës, të dy të rënë në luftën çlirimtare të Kosovës, bashkëshortët Fehmi dhe Xhevdet Lladrovci. "Le t'i themi faleminderit heroit Fehmi Lladrovci dhe heroines Xhevë Krasniqi-Lladrovci, që na bashkuan që gjithë sot këtu për t'u uruar rikthimin në bronza në Drenas, në Drenicë e në Kosovë, pasi ata janë jo vetëm nderi i historisë së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por janë nder i mbarë kombit shqiptar. Sepse janë një shembull i jashtëzakonshëm i sakrificimit më sublim në emër të lirisë dhe të emër të idealeve më të mëdha, të cilat sollën Kosovën e lirë dhe Kosovën e pavarur", deklaroi z.Meta. Të pranishëm në ceremoni ishte edhe Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi, kryeministri Ramush Haradinaj dhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli si dhe shumë ish-luftëtarë të UÇK-së. Po dje kryetari i LDK-së, Isa Mustafa zhvilloi sot një takim me presidentin Ilir Meta. Gjatë bisedës, dy zyrtarët folën për çështjen e shkëmbimit të territoreve mes Kosovës dhe Serbisë. Ishte vetë z.Mustafa, ai që komentoi takimin me Metën në "Facebook". "Kisha kënaqësinë të pres në takim Presidentin e Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta. Presidenti Meta i prezantova pikëpamjet e LDK-së se dialogu ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë duhet të jetë forma e vetme e normalizimit të raporteve, por se dialogu duhet të vazhdojë me institucione që kanë legjitimitet të konfirmuar nga zgjedhjet e parakohshme dhe të lira. Po ashtu, i rikonfirmova Presidentit Meta pozicionin e paluhatshëm të LDK-së se hapja e temës së ndryshimit të kufijve është e papranueshme dhe e rrezikshme, sepse kjo e rihap temën e mbyllur me deklarinë e pavarësisë dhe se diskutimi i kufijve është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës. Në këtë takim po ashtu shpreha falënderimin tim për Presidentin Meta, për interesimin e tij të vazhdueshëm në procesin e rehabilitimit tim shëndetësor", shkruan Mustafa.

Zonja Millard, është kënaqësi t'ju kem në këtë intervistë. Kjo është vizita juaj e parë në Shqipëri. Cilat janë çështjet më problematike që Departamenti i Shtetit i sheh si më shqetësueset për Shqipërinë?

Klodiana, shumë faleminderit që po më intervistonin sot! Është shumë kënaqësi... Ashtu siç thoni edhe ju, është vizita ime e parë në Shqipëri dhe jam e nderuar që jam këtu, në këtë vend të bukur. Shqipëria dhe Shtetet e Bashkuara janë partnerë të ngushtë dhe ne punojmë së bashku në shumë gjëra. Si të tillë, unë pata diskutime të mira mbi prioritetet mbi të cilat ne punojmë së bashku. Ne e kemi parë Shqipërinë të përparojë në shumë fusha dhe kemi parë fusha tek të cilat vazhdohet të punohet dhe sigurisht, pjesë e kësaj pune është të sigurohemi që reforma demokratike të vazhdojë dhe sidomos reforma në drejtësi të vazhdojë dhe unë e di që është bërë shumë punë dhe se ajo punë vazhdon.

Raporte të Departamentit të Shtetit, por edhe të institucioneve të tjera ndërkombëtare e shohin Shqipërinë si një burim të madh të trafikimit të lëndëve narkotike, ndërkohë që ka edhe një perceptim të lartë të korrupsionit. A i ngritët këto çështje gjatë takimeve tuaja në Tiranë?

"DREJTËSIA"
"Kjo është një fushë e rëndësishme për të punuar së bashku dhe mendoj se një nga gjërat që po presim janë rezultatet konkrete dhe e di që janë planifikuar disa institucione në vend. Unë u informova për SPAK-un dhe BKH-në, që mendoj se do të jenë institucione kyçe, të cilat ndërsa do mund të bëjnë punën e tyre të rëndësishme, do të ndihmojnë që të shohim përparim thelbësor në këtë fushë të rëndësishme", theksoi zj.Millard.

Ju e dini që trafiku i drogës është një problem në shumë vende dhe diçka shumë shqetësuese. Sigurisht, shpesh ai lidhet me korrupsionin, gjë e cila e bën shumë të vështirë për t'u zgjidhur. Sigurisht, ky është një prioritet si për Shtetet e Bashkuara, ashtu edhe për Shqipërinë në punën tonë të përbashkët si partnerë dhe aleatë, e sigurisht që ka shumë punë për t'u bërë në këtë drejtim, sidomos në dënimin e trafikantëve kryesorë dhe njerëzve që mundësojnë trafikun. Kjo është një punë vërtet shumë e rëndësishme dhe diçka në të cilën, nëse shihet përparim, do të jetë më përfitim për të gjithë shqiptarët.

Departamenti i Shtetit ka qenë mbështetësi kryesor i reformës në drejtësi në Shqipëri. A mendoni se reforma, e cila po zbatohet, po jep rezultatet që priteshin, duke pasur parasysh që është kundërshtuar nga shumë palë?

Kjo është një fushë

shumë e rëndësishme. Ndonjëherë në Amerikë përdorim shprehjen "nëse do të ishte e lehtë, do të ishte bërë me kohë", por ja ku jemi. Kjo është një fushë e rëndësishme për të punuar së bashku dhe mendoj se një nga gjërat që po presim janë rezultatet konkrete dhe e di që janë planifikuar disa institucione në vend. Unë u informova për SPAK-un dhe BKH-në, që mendoj se do të jenë institucione kyçe, të cilat ndërsa do mund të bëjnë punën e tyre të rëndësishme, do të ndihmojnë që të shohim përparim thelbësor në këtë fushë të rëndësishme.

Në mendimin tuaj, a është vetingu në politikë një nismë e vënë mbi tavolinë nga opozita, e nevojshme në këtë kohë?

Është gjithnjë mirë të shihet se çfarë mund të bëhet dhe mund të jetë një rol i rëndësishëm për opozitën dhe qeverinë që të punojnë për të parë se çfarë mund të bëhet tjetër, por mendoj se

çelësi është ngritja dhe funksionimi i këtyre institucioneve të rëndësishme, mendoj se ky duhet të jetë fokusi në këtë moment.

Dhe pyetja e fundit. Cili është pozicioni juaj në lidhje me disa diskutime të fundit mbi korrigjimin e kufijve midis Kosovës dhe Serbisë? A i mbështesin Shtetet e Bashkuara ndryshimet e kufijve në Ballkan?

Ne mendojmë se marrëdhënia midis Kosovës dhe Serbisë është duke u normalizuar. Ajo marrëdhënie është thelbësore për të gjithë rajonin. Besoj ju e keni dëgjuar së fundmi këshilltarin tonë për Sigurinë Kombëtare, ambasadorin Bolton teksa është shprehur për këtë çështje të rëndësishme dhe ajo është në të vërtetë politika jonë. Mendoj se në këtë moment, udhëheqësit e këtyre dy vendeve po tregojnë se kanë nismë, po tregojnë se kanë imagjinatë, prandaj le të shohim se çfarë do të arrijnë dhe ne do ta shqyrtojmë, por mendoj se kemi shpresë se kjo do të jetë diçka e mirë për të gjithë rajonin.

Faleminderit, ishte kënaqësi!

Krye zv.ndihmës Sekretarja e Shtetit Millard: Klodiana, shumë faleminderit! Ishte kënaqësi të isha me ju sot, në këtë vend të bukur.

SHPALLJE ANKANDI
Date 24.09.2018, Ora 16:00
Shoqëria Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.
Sipall ankandin e tretë për pasurinë e paluajtshme të dorezuarit Enkeleja Shaban Novaku dhe dorëzuesit Adilali Sefer Novaku.
- "Truall" me sipërfaqe 100 m² dhe "Ndertesë me 3 kate me sipërfaqe 90 m² secili, nr. i pasurisë 4/106, zona kadastrale 8591, vll. 13, faqe 49, adresa: Lajçë Nr. 1, Prizren.
Çmimi fillestar i ankandit të tretë është në shumën 6 552 000 (gjashtë milionë e pesëqind e pesëdhjetë e dy mijë) lekë.
Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

SHPALLJE ANKANDI
Date 24.09.2018, Ora 16:45
Shoqëria Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.
Sipall ankandin e parë për pasurinë e paluajtshme të dorezuarit Bajfar Alush Murto:
- "Truall" me sipërfaqe 300 m² dhe ndërtesë 81 m², regjistruar në regjistrin hipotekor me volum nr. 3, faqe 76, zona kadastrale 3316, nr. i pasurisë 987, adresa: Shalës, Sarandë.
Çmimi fillestar i ankandit të parë është në shumën 1 440 000 (një milion e katërqind e dyzet mijë) lekë.
Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

Gjata e Braçe: Kushtetuta parashikon mandat të plotë për Genti Sejkon

Guvernatori Sejko, mandat 7-vjeçar edhe në Këshillin Mbikëqyrës

Zgjedhja e anëtarëve të rinj, hapet gara për 6 vende

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Genti Sejko do të jetë anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës Qendrore deri në përfundim të mandatit 7-vjeçar si guvernator. Edhe pse Genti Sejko është zgjedhur anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë në vitin 2012, pas dorëheqjes së Ardian Civicit nga ky pozicion, zgjedhja e tij në krye të Bankës Qendrore i garanton mandatin e plotë në Këshillin Mbikëqyrës. Eksperti i ligjor Çlirim Gjata dhe kreu i Komisionit të Ekonomisë, Erjon Braçe janë në linjë në komentet e tyre në lidhje me përfundimin ose jo të mandatit të Genti Sejkos në pozicionin e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. "Mandati i guvernatorit është shtatë vjet dhe detyra në Këshillin Mbikëqyrës është 7 vjet thotë Kushtetuta. Kushtetuta përdorërisa nuk e përcakton që zëvendësuesin pjesën e mbetur të mandatit, atëherë ka mandat të plotë 7-vjeçar", - thotë Gjata. Edhe kreu i Komisionit të Ekonomisë, Erjon Braçe, duke iu referuar Kushtetutes shprehet se Sejko ka mandat të plotë edhe në Këshillin Mbikëqyrës. "Në referencë të Kushtetutës, mandati i guvernatorit të Bankës së Shqipërisë është 7-vjeçar, që do të thotë se guvernatori aktual e ka marrë këtë mandat në shkurt të vitit 2015 dhe duhet që ta përfundojë këtë mandat. Nëse nuk bie në rastet që Kushtetuta parashikon për shkarkimin e tij, e përfundon në shkurt të vitit 2022", - deklaron Braçe.

VENDET VAKANTE

Debatit në lidhje me përfundimin ose jo të mandatit të Genti Sejkos në Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë ka nisur ditë më parë, por aludimet morën fund dje kur Drejtoria e Monitorimit pranë Kuvendit shpalli listën me emrat e



Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Genti Sejko

EMERIMI

Genti Sejko u emërua guvernator i Bankës së Shqipërisë në datë 5 shkurt 2015 nga Kuvendi i Shqipërisë, bazuar në dekreten e Presidentit të Republikës së Shqipërisë. Ai mori mandatin e lënë përgjysmë të nisur nga guvernatori Fullani në vitin 2011.

ZGJEDHJA E ANËTARËVE

Sipas ligjit të Bankës së Shqipërisë, të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës zgjidhen dhe emërohen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, mbështetur në propozimet e bëra si më poshtë:

- Pesë anëtarë propozohen nga Kuvendi.
 - Tre anëtarë propozohen nga Këshilli i Ministrave.
 - Një anëtar propozohet nga Këshilli Mbikëqyrës.
- Guvernatori zgjidhet nga Kuvendi, me propozimin e Presidentit të Republikës.

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë zgjedh dhe emëron zëvendësguvernatorin, mbështetur në propozimin e bërë nga guvernatori.

KRITERET

Në përfundim të mandatit të 3 prej anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, Këshilli i Ministrave inkurajon personat që përmbushin kriteret të aplikojnë, thuhet në njoftimin zyrtar.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret, si më poshtë vijon:

1. Të ketë:

- a) Arsimin e lartë ekonomik ose juridik.
- b) Përvojë profesionale në çështje financiare dhe bankare.
- c) Kualifikime profesionale të proffilit.

2. Të mos ketë pengesat e mëposhtme:

- a) Është dënuar nga gjykata për një vepër penale, për të cilën ligji parashikon dënimin me burgim.
- b) Është në pamundësi për të paguar detyrimet monetare ose është deklaruar i falimentuar dhe nuk është rehabilituar.
- c) Është ndaluar ose pezulluar nga gjykata të ushtrrojë detyrën si nëpunës shtetëror apo në shërbimin publik ose të ushtrtojë veprimtarinë apo mjeshtrinë.

3. Gjatë ushtrimit të detyrës, në mënyrë aktive merr pjesë në veprimtari politike.

Funksioni i anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës është i papajtuashëm me atë të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, të deputetit në Kuvend, të anëtarit të Këshillit të Ministrave si dhe të punonjësit, të administratorit dhe të aksionarit, me pjesëmarrje ndikuese në bankën e nivelit të dytë ose në subjektet që licencohen nga Banka e Shqipërisë.

Dokumentet që duhet të dorëzohen janë:

- Kërkesë për aplikim.
- Kopje e letërnjoftimit.
- Curriculum Vitae në gjuhën shqipe.
- Dokumente të diplomimit dhe të kualifikimeve profesionale të kërkuara.
- Dokument që të provojë vjetërsinë në profesion.
- Formular të plotësuar e të firmosur të vetëdeklarimit për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrjnë funksione publike, në përputhje me ligjin nr.138/2015, të ndryshuar.

Vetëdeklarim se nuk është në pamundësi për të paguar detyrimet monetare ose deklaruar i falimentuar.

- Vetëdeklarim se nuk është ndaluar ose pezulluar nga gjykata të ushtrrojë detyrën si nëpunës shtetëror apo në shërbimin publik ose të ushtrrojë veprimtarinë apo mjeshtrinë.
 - Vetëdeklarim se gjatë ushtrimit të detyrës nuk merr pjesë në mënyrë aktive në veprimtari politike.
- (Deklarimi i rremë, përveç përgjegjësisë penale sipas ligjit, sjell përjashtimin nga çdo procedurë e mëtejshme.)

GJASHTË ANËTARËT E TJERË QË U MBARON MANDATI NË NËNTOR:

1. Dhori Kule është zgjedhur anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë në nëntor të vitit 2011.
2. Ela Golemi është zgjedhur anëtarë e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë në nëntor 2011 dhe nga muaji gusht 2015 është anëtare edhe e Komitetit të Auditimit të Bankës së Shqipërisë.
3. Elisabeta Gjoni është zëvendësguvernatore e parë e Bankës së Shqipërisë që prej muajit janar 2012. Ajo është edhe anëtare e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë që prej muajit nëntor 2011.
4. Petraq Milo është zgjedhur anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë në nëntor të vitit 2011.
5. Arben Malaj zëvendësoi mandatin e Ermelinda Meksit.
6. Denada Priti ka marrë mandat zëvendësues në nëntor të vitit 2014.

anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës që u ka mbaruar mandati. Qeveria shpalli dy ditë më parë garën për tre anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Ndërkohë, Drejtoria e Monitorimit pranë Kuvendit ka njoftuar institucionet përkatëse për përfundimin e mandatit për gjashtë anëtarë të Këshil-

lit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë si dhe kërkesën për zgjedhje të reja. Në këtë listë nuk figuron emri i Genti Sejkos, i cili është zgjedhur anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë pas dorëheqjes së Ardian Civicit në vitin 2012. Ardian Civici u zëvendësua nga Genti Sejko dhe ky mandat

i përfundon në fund të këtij viti. Por, Genti Sejko është zgjedhur si guvernator me propozim të Presidentit të Republikës në vitin 2015 dhe mandati i tij është shtatëvjeçar, që e bën atë automatikisht edhe anëtar të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë deri në përfundim të mandatit si guvernator.

Bizneset e agroturizmit dhe ato me xhiro deri në 14 milionë lekë do të tatonen me 5% tatim fitimi nga 15% që tatonen aktualisht, duke filluar që nga 1 janari 2019. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve njoftoi sot tatimpaguesit për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar. Dispozitat ligjore të ndryshuara, si nevojë e zhvillimit të tregut kanë saktësuar disa çështje, të cilat në mënyrë të përmblodhur po i trajtojmë si më poshtë: Në nenin 8/1, në të cilin janë përcaktuar kategoritë e të ardhurave personale të përjashtuara nga tatimi. Në pikën 11 është saktësuar trajtimi i kalimit të së drejtës së pronësisë mbi

Tatimet: Ja bizneset që do të paguajnë tatim fitimi 5% më 1 janar 2019

tokën bujqësore, për rastet kur origjina e pronës është fitimi sipas ligjit nr.7501. Sipas këtij parashikimi, përjashtohen gjithashtu rastet e kalimit të së drejtës së pronësisë brenda lidhjes gjinore burrë, grua, fëmijë, nëpërmjet dhurimit dhe/ose heqjes dorë nga pasuria, kur pasuria rrjedh nga bashkëpronësia e detyrueshme e fituar në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991. "Për tokën", të ndryshuar. Në nenin 11 "Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme", është saktësuar koncepti truall dhe tokë bujqësore. Gjithashtu, në këtë nen është

parashikuar që shkëmbimi i truallit me sipërfaqe ndërtimi, bazuar në një kontratë shkëmbimi nuk përbën moment për llogaritje të ndonjë fitimi kapital nga transferimi i pasurisë së paluajtshme. Në vijim të saktësimeve të mësipërme, në nenin 20 janë shfuqizuar paragrafet 3 dhe 4, të cilët trajtonin shpenzimet e njohura në veprimtarinë e ndërtimit, në lidhje me kontratat e shkëmbimit. Në nenin 28, janë bërë diferencime të shkallës së Tatimit mbi Fitimin për disa kategori: 5% për tatimpaguesit me të ardhura deri në 14 000 000 lekë në vit;

15% për tatimpaguesit me të ardhura mbi 14 000 000 lekë në vit; 5% për personat juridikë, të cilët zhvillojnë veprimtari ekonomike sipas ligjit nr. 38/2012. "Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor"; 5% për subjektet, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si "agroturizëm", sipas legjislativimit në fuqi në fushën e turizmit. (Kjo shkallë aplikohet për një periudhë 10-vjeçare për personat juridikë që përfitojnë statusin "subjekt i certifikuar agroturizmi", deri më 31 dhjetor 2021. Aplikimi i shkallës së reduktuar fillon në vitin tatimor pasardhës,



pas përfitimit të statusit "subjekt i certifikuar agroturizmi.") Një ndryshim i vendimit për miratimin e rezultativitetit dhe destinimit i fitimit), është edhe heqja e detyrimit të subjek-

tit "person fizik", për të dorëzuar vendim për shpërndarje dividendi, pavarësisht përgjegjësisë tatimore, duke qenë se personi fizik, sipas konceptit të ligjit tregtar nuk ka personalitet juridik dhe është përgjegjës me të gjitha pasuritë e tij.

U paguan 2 mijë € për ndryshimin e akuzës ndaj të pandehurit

Dyshohen si të përfshirë në aferë korruptive, arrestohet avokatja, pezullohet prokurori



të dhëna të tjera. Të arrestuarit akuzohen për veprën penale "Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë e kryer në bashkëpunim", parashikuar nga neni 319/25 i Kodit Penal", thuhet në

Një prokuror është pezulluar nga detyra ndërsa një avokate është vënë në pranga pas zbulimit të një rasti korruptiv në Prokurorinë e Tiranës. Kamerat e sigurisë së institucionit dhe përgjimet telefonike ngrenë dyshime se janë paguar 2 mijë euro të prokurori i Tiranës, Përparim Hasa përmes avokates Donada Lepenica, me qëllim ndryshimin e akuzës për një të pande-

hur. Prokurori i Tiranës është pezulluar nga detyra me vendim të Gjykatës së Krimeve të Rënda, ndërsa është arrestuar avokatja. Paratë janë paguar nga një i pandehur, i cili ka kërkuar ndryshimin e akuzës nga prokurori i çështjes. Prej 4 ditësh, Krimet e Rënda kanë bllokuar serverin e kamerave të sigurisë së Prokurorisë së Tiranës. Pamjet filmike kanë fiksuar momentin kur avokatja futet në zyrën e prokurorit. Ndërsa nga

përgjimet telefonike zbulohet se avokatja i drejtohet të pandehurit që ajo mbron se, "gjithçka e kam zgjidhur me prokurorin". Biseda me të akuzuarin është bërë pak çaste pas takimit të saj me prokurorin e Tiranës, Përparim Hasa, në zyrën e këtij të fundit. "Finalizohet operacioni policor i koduar "Ndërmjetësi". Ekzekutohen masat e sigurisë "Arrest me burg" për 3 shtetas. Specialistët për Hetimin e Korrupsionit në bashkëpunim me Prokuror-

inë e Krimeve të Rënda Tiranë në kuadër të operacionit policor të koduar "Ndërmjetësi", bënë ekzekutimin e Vendimit Penal të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, e cila ka caktuar masën e sigurimit "Arrest me burg", për shtetasit: Donata Lepenica, 57 vjeçe banuese në Tiranë (avokate private në qytetin e Tiranës); Zejrir Bala, 32 vjeç, banues në Tiranë; Megi Naksi, 31 vjeçe, banuese në Tiranë. Për shkak të hetimit nuk bëjmë me dije

Furtunë te Krimet e Rënda, më datë 25 shtator pritet të jepet pretenca

Dosja "Shullazi", Marku ndëshkon 10 prokurorët që refuzuan shortin

Transferohen në rrethe Hajdarmataj, Çela dhe Muhametaj

Prokurorja e Përgjithshme, Arta Marku ka urdhëruar transferimin e përkohshëm në rrethe të tre nga dhjetë prokurorët që refuzuan hedhjen e shortit për dosjen Shullazi. Bëhet fjalë për prokurorët: Olsian Çela, i cili do të transferohet në Prokurorinë e Beratit, Sonila Muhametaj, e cila do të transferohet në Prokurorinë e Pukës dhe Besim Hajdarmatajn, i cili do të transferohet në Prokurorinë e Pogradecit.

Gjithashtu, kryeprokurorja e përkohshme kërkoi që për këta prokurorë, por edhe për shtatë të tjerë të nisë edhe hetimin disiplinor për thyerje të urdhrat të drejtueses së Krimeve të Rënda Donika Prela, në hedhjen e shortit për dosjen Shullazi. Bëhet fjalë për prokurorët Përparim Kullurin, Behar Dibrën, Arenc Çelën, Edvin Kondilin, Pranvera Pustinë, Eugen Beçin dhe Blerim Tominajn. Kujtojmë se dy ditë më parë prokurorët e Krimeve të Rënda kanë braktisur mbledhjen e thirrur nga drejtuesja e tyre, Donika Prela. Këta prokurorë refuzuan hedhjen e shortit në procedimin penal në gjykim në ngarkim të të pandehurve Emiljano Shullazi, Gilmando Dani, Endrit Qyqja, Endrit Zela dhe Blerim Shullazi, të cilët ndodhen pas hekurave për një sërë akuzash. "Prokurori i Përgjithshëm znj. Arta Marku duke marrë shkas nga ngjarja e fundit e datës 19 shtator 2018 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, mbi refuzimin nga ana e prokurorëve për hedhjen e shortit në procedimin penal në gjykim në ngarkim të të pandehurve Emiljano Shullazi, Gilmando Dani, Endrit Qyqja, Endrit Zela dhe Blerim Shullazi, për kryerjen e veprave penale parashikuar nga neni 109/b, 333/a, 334 etj. të Kodit Penal urdhëroi fillimin e hetimit disiplinor ndaj prokurorëve: Olsian Çela; Përparim Kulluri, Behar Dibra; Sonila Muhametaj; Arenc Çela; Edvin Kondili; Pranvera Pustina; Eugen Beçi; Blerim Tominaj dhe Besim Hajdarmataj", thuhet në njoftimin e prokurorisë. Të gjithë refuzojnë të përballen në gjyq me



Raporti vjetor për kriminalitetin, Marku: 11 mijë raste për procedim në 2017-ën

Në seancë plenare që nisi ditën e djeshme prej orës 10:00 kryeprokurorja e Përgjithshme e përkohshme, Arta Marku, prezantoi raportin vjetor për kriminalitetin për vitin 2017. Marku ka thënë se Prokuroria e Përgjithshme ka dërguar 11 mijë raste për procedim dhe se kallëzimet penale janë rritur me 10%. Marku ka thënë se prioritet për prokurorinë mbetet hetimi i zyrtarëve të lartë. "Me kriminalitet më të ulët është Dibra, ndërsa me i lartë regjistrohet në Vlorë. Megjithatë ka një rritje të njoftimeve sasiore, nuk ka shumë lidhje dhe përputhje me njoftimet cilësore. Lufta kundër krimtë të organizuar dhe korrupsionit është pri-



orit për ne. Lufta kundër korrupsionit ka pasur rritje me 60% të rasteve të dërguara në gjykatë. Është kërkuar nga prokurori që në 60% është kërkuar burgim dhe në 40% të rasteve është kërkuar dënimi alternativ. Prokurorritë kanë zhvilluar analiza të vazhdueshme për punën e gjykatave. 13 procedime penale për

funksionarët e lartë. Kemi një plan anti-kanabis deri në vitin 2020. Treguesit statistikorë tregojnë për procedime penale për zgjidhjet e martesës. Procedimet më të larta janë për vjedhje. Kemi hetuar me përparsi dhunën në familje", tha Prokurorja e Përgjithshme Arta Marku.

Emiljano Shullazin dhe miqtë e tij dhe këmbëngulin që procesi të ndiqet nga dy prokurorët që zhvilluan edhe hetimet. Çështja Shullazi mbeti jetim, pasi Elisabeta Imeraj u komandua si drejtuese e re e prokurorisë së Tiranës, ndërsa Ened Nakuci është larguar për arsye shëndetësore për një afat të caktuar. Pas kësaj, Donika Prela autorizoi Besim Hajdarmatajn, që të merrte pjesë në seancën e datës 11 shtator. Ish-drejtesja i Krimeve të Rënda deklaroi në sallën e gjyqit se merrte përsipër të mbronte akuzën në proces, por i duhej kohë të studionte dosjen e të përgatiste pretencën. Avokatët kërkuan me ngul largimin e tij, pasi me herët e kanë akuzuar ashpër, madje edhe kërkuar si dëshmitar në gjyq. E gjendur në këtë situatë Prela tentoi të hidhte shortin për caktimin e grupit prej katër prokurorëve që do merrnin në duar çështjen Shullazi. Hajdarmataj ndërkohe e informoi se ishte caktuar të ishte në këtë listë. Për ngërçin e krijuar u kërkuua ndihma e kryeprokurorës. Seanca e radhës për dosjen "Shullazi" është parashikuar për datë 25 shtator, ku pritet të jepet pretenca. Banda e Shullazit akuzohet për krijimin e grupit të strukturuar kriminal, kanosje për shkak të detyrës ndaj Mynyr Konit e Dhori Kules dhe shtrëngim me anë të kanosjes për dhënie pasurie kundër Ylvi Beqes për ish-hotel "Vollgën" në Durrës. Shullazi rrezikon deri në 15 vjet burg për akuzat, po ashtu edhe anëtarët e bandës; Gilmando Dani, Besmir Shullazi, Endrit Qyqja dhe Endrit Zela.

E qëllloi me thikë babai i të dashurës, vdes 38-vjeçari

TIRANË- 38-vjeçari i plagosur dy ditë më parë në zonën e Unazës së Re ka ndërruar jetë në Spital. Olsi Lelo u qëllua dhe me thikë nga babai i të dashurës së tij. Ai nuk mundi t'i mbijetonte plagëve të marra dhe dje ka ndërruar jetë në spital. Babai i vajzës me të cilën ishte lidhur Lelo, 51-vjeçari Rezmi Caushaj ishte kundër kësaj marrëdhënie. Kjo pasi 38-vjeçari kishte qenë i martuar më parë, ndaj edhe Rezmi Caushaj ishte kundër kësaj marrëdhënie dhe kishte tentuar disa herë ta ndante Lelon nga e vajza e tij. Po ashtu thuhet se babai e kishte dhunuar disa herë vajzën e tij, 23 vjeçe, madje kjo e fundit kishte kërkuar edhe urdhrë mbrojtje nga policia. Mësohet se Caushaj e kishte ftuar 38-vjeçarin në kafe ku edhe e ka qëlluar me thikë. Ngjarja ndodhi paraditen e së mërkurës në zonën e Unazës së Re'. Dy burrat fillimisht kanë debatuar me njëri-tjetrin dhe më pas 51-vjeçari e ka qëlluar me thikë. I plagosuri është dërguar me urgjencë në Spitalin e Traumës ku ka ndërruar jetë pasi plaga i kishte prekur organet jetike.

TIRANË - Gjykata e Krimëve të Rënda ka zhvilluar ditën e djeshme seancën gjyqësore për Fadil Kasemin, i cili vrau ish-bashkëshorten e tij gjyqtare, Fildez Hafizi. Përpara trupës gjyqësore ka dëshmuar Klodian Tafa, drejtuesi i automjetit me të cilin Kasemi është larguar nga vendngjarja drejt komisarariatit nr.1 të policisë në kryeqytet. Tafa është njeriu i parë me të cilin ka komunikuar 55-vjeçari pas krimit dhe nje-



Klodian Tafa: Më tha "vraja gruan, të vras edhe ty"

Vrasja e Fildez Hafizit, shoferi që u mor peng nga Kasemi dëshmon në gjykatë

riu me të cilin u largua nga vendi i ngjarjes. "Kasemi më doli para makinës, kishte pistoletë. Më tha që do të hipte në makinën time, por unë i thashë se kompania s'na lejon të marrim të tjerë persona. Fadil Kasemi më kërcënoi me armën që kishte në dorë. Më tha 'kam vrrarë gruan dhe të vras edhe ty'. Sapo u nisa, nga pas filloi të na ndiqte një motor policie. Kalova kryqëzimin të 'Xhamllëku' me semafor të kuq. Pas kryqëzimit, Kasemi hoqi karikatorin nga pistoletat. U futa kundravajtje drejt komisarariatit numer 1. E futa makinën në oborrin e komisarariatit. Kasemi zbriti me armë në dorë, aty u ndalua nga policia", ka treguar shoferi. Mesditën e

31 gushtit 2017, Fadil Kasemi vrau me armë zjarri ish-bashkëshorten e tij gjyqtare, Fildez Hafizi. Pas ndarjes, Kasemi kishte tentuar edhe më herët të vriste Fildezin, në plazhin e Golemit verën e vitit 2015, por ndërhyrja e personave të tjerë e shpëtoi gjyqtaren. Edhe pse i armatosur me armë zjarri pa leje dhe në tentativë vrasjeje, Fadil Kasemi del nga burgu dhe dy vite më pas vret bashkëshorten gjyqtare, Fildez Hafizi, nënë e dy fëmijëve.

Hetimet dhe përgjimet, SHÇBA arreston edhe dy persona nga Fieri

GJIROKASTËR

Gjashtë efektivë të Policisë Kufitare në Gjirokastrë janë arrestuar nga Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat (SHÇBA), pasi akuzohen për korrupsion pasiv, shpërdorim detyre dhe dhënie ndihme për kalim të paligjshëm të kufirit. Gjithashtu, kanë përfunduar në pranga edhe dy shtetas nga Fieri. SHÇBA bën me dije se pas një hetimi disamujor proaktiv me metoda speciale të hetimit, ka goditur veprimtarinë e paligjshme të ushtruar nga 6 punonjës policie dhe disa shtetas, në vijën e kalimit kufitar mes Shqipërisë dhe Greqisë, në zonën e Kakavijës. Mësohet se duke shpërdoruar detyrën, këta punonjës policie në kohë të ndryshme kanë lehtësuar kalimin e paligjshëm nëpërmjet vijës së gjelbër kundrejt shpërbimit, për shtetas të ndryshëm që kanë pasur probleme me lëvizjen në zonën Shengen. Për disa muaj me radhë, efektivë të SHÇBA kanë mbajtur nën vëzhgim, përgjatur dhe kryer veprime simuluese për të dokumentuar veprimtarinë e paligjshme të këtyre shtetasve. Gjykata e rrethit gjyqësor Gjirokastrë ka vendosur për këta punonjës pol-

Korrupsioni, prangosen gjashtë policë në Kakavijë

Lejonin kalimin e refugjatëve dhe të personave "non grata" në Shengen



icie masën e sigurisë "Arrest me burg". Bëhet fjalë për shtetasit Gentian Gjollleshi, Luan Shosha, Roland Gega punonjës i Policisë Kufitare Gjirokastrë; Afrim Çomo, Edmond Nikolla dhe Fatmir Beqo, të gjithë punonjës të Policisë Kufitare Gjirokastrë. Ndërkaq, SHÇBA ka vënë në pranga dhe shtetasit Besnik Sinani dhe Kastriot Senka nga

- TË ARRESTUARIT**
1. Gentian Gjollleshi, punonjës i Policisë Kufitare Gjirokastrë.
 2. Luan Shosha, punonjës i Policisë Kufitare Gjirokastrë.
 3. Roland Gega, punonjës i Policisë Kufitare Gjirokastrë.
 4. Afrim Çomo, punonjës i Policisë Kufitare Gjirokastrë.
 5. Edmond Nikolla, punonjës i Policisë Kufitare Gjirokastrë.
 6. Fatmir Beqo, punonjës i Policisë Kufitare Gjirokastrë.
 7. Besnik Sinani, nga Fieri.
 8. Kastriot Senka nga Fieri.

Fieri. Ky i fundit ishte shpallur në kërkim si pjesë e kësaj veprimtarie të paligjshme, por u kap mbrëmë. Ata akuzohen se kanë lejuar edhe kalimin e refugjatëve sirianë nga Greqia në drejtim të Shqipërisë për të kaluar më pas në vendet e BE-së. Ndërkohë pritet që të arrestohen edhe 4 policë të tjerë, pasi dyshohet se janë përfshirë në këtë skemë.

SHKURT

6 vjedhje në 17 ditë, bie në pranga i 'merrshmi' i Elbasanit

Policia e Elbasanit ka arrestuar një 29-vjeçar, i cili akuzohet për një sërë vjedhjesh të kryera në këtë qytet gjatë këtij muaji. Bëhet fjalë për 29-vjeçarin Melser Jangulli, banues në lagjen "Vullnetari", i cili u prangos dy ditë më parë nga policia gjatë operacionit të koduar "Nata e Fundit". Sipas bluve, riu brenda një harku kohor prej 17 ditësh (nga 3 shtatori deri më 19 shtator) akuzohet se ka kryer të paktën 6 vjedhje (të dokumentuara), madje më 5 shtator kishte realizuar dy bastisje. Mësohet se Jangulli ka vjedhur një argjendari, dygane dhe kioska. Policia sekuestroi në cilësinë e provës materiale unaza, varëse, byzylyk, disa monedha metalike, aparatet celularë. Si dhe materialet që autori dyshohet se i ka përdorur për të kryer vjedhjet: një çantë, sqepar, një palë pinca, 2 kaçavida, një levë metalike, një palë gërsërë prerëse, një material qafore leshi dheve me ngjyrë të zezë dhe shiritat. Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, për veprën penale "Vjedhja".

I vë flakën godinës së bashkisë, kapet 45-vjeçari

LIBRAZHD - Artan Balla, i cili prej 5 ditësh ishte kthyer nga Greqia ku ishte emigrant, mbrëmjen e së mërkurës i ka vënë zjarri Bashkisë së Librazhdit, duke djegur vetëm derën e saj. 45-vjeçari që ndërmori aktin është person i njohur policinë, me precedent të shumtë penalë dhe madje i dënuar disa herë. Mësohet se pas kthimit nga Greqia, ai i kishte dhënë ultimatum kryetarit të bashkisë, Kastriot Gurra për ta punësuar. Por, pasi i është bërë e ditur se ai nuk plotëson asnjë kriter për t'u punësuar, ai i kërkoi të mos punësohej. Por, pasi i është bërë e ditur se ai nuk plotëson asnjë kriter për t'u punësuar, ai i kërkoi të mos punësohej. Por, pasi i është bërë e ditur se ai nuk plotëson asnjë kriter për t'u punësuar, ai i kërkoi të mos punësohej. Por, pasi i është bërë e ditur se ai nuk plotëson asnjë kriter për t'u punësuar, ai i kërkoi të mos punësohej.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
 DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
 SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje e një pajisje pirun elektrik për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 1,996,800 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
 BIC: STANALTR
 IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje e një pajisje pirun elektrik për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 15 Tetor 2018, ora 14:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Kapet me heroinë e kanabis pranë shkollës ish-i dënuari për vrasje

DURRËS - Policia e Durrësit ka finalizuar operacionin e koduar "Fusha e Rërës", duke vënë në pranga një 46-vjeçar të dënuar më parë për vrasje me dashje, pasi që shpërdante drogë pranë shkollave. I arrestuari është shtetasi Ardian Llana, banues në këtë qytet. "Mbi bazën e informacioneve të siguruar u organizua dhe u zhvillua operacioni i koduar "Fusha e Rërës", ku u kap në afërsi të një shkolle shtetasi i mësipërm. Gjatë kontrollit, shtetasit Ardian Llana iu gjet dhe iu sekuestrova në cilësinë e provës materiale një sasi lëndë narkotike kanabis sativa dhe doza heroine (56 grawe canabis dhe 7 doza heroine). Materialet do t'i kalojnë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës në ngarkim të shtetasit të lartpërmendur", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë.

Ne kuader të zbatimit të projektit të dixhitalizimit të shërbimit notarial kombëtar për venien në funksionim të databazës shtetërore NISA, Dhoma Kombëtare e Neterisë (DH.K.N.) from Operatorët Ekonomike të huaj ose vendas për të marrë pjesë në këtë procedurë. Dokumentat e projektit mund të tërhiqen perkundrejt pagesës prej **10.000 leke**, pranë Dh.K.N. në adresën Rruga Vaso Pasha, Tiranë, Shqipëri. Propozimet do të pranohen brenda datës **7 tetor 2018 ora 10:00 AM**

Prokuroria: Abuzuan me detyrën, blenë më shumë ilaçe se sa nevojiteshin

Senand Nikshiqi

SHKODER

Furtunë" në Spitalin Rajonal të Shkodrës. 9 punonjës të këtij institucioni shëndetësor, mes të cilëve dhe dy ish-drejtes kanë përfunduar me masën e sigurisë "Arrest me burg" dhe "Arrest shtëpie". 5 prej tyre janë me masën "Arrest me burg", nga të cilët 3 janë të arrestuar dhe 2 të shpallur në kërkim, ndërsa 4 të tjerë janë me masën e sigurisë "Arrest shtëpie". Ata akuzohen se kanë shpërdoruar detyrën, duke blerë ilaçe dhe medikamente mjekësore jashtë kriteve dhe kapacitetit të spitalit. Arrestimi i mjekëve dhe infermierëve, mori shkas pas një auditimi të bërë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në spitalin e qytetit verior, nga ku u konstatua se ishin bërë shkelje të repartit i hemodinamikës e kardiologjisë. Menjëherë pas auditit të KLSH-së, prokuroria nisi hetimet. Pas dy muajsh hetime intensive, organi i akuzës bëri me dije se është arrestuar ish-drejtori i këtij spitali, Përparim Çela (u shkarkua para 1 viti), ndërsa është shpallur në kërkim ish-drejtorja e njëkohësisht mjekja Dhurata Uruçi. Po ashtu është arrestuar shefi i koronarografisë, Luan Dragusha, infermieri i hemodinamikës Renato Kepi, ndërsa është shpallur në kërkim mjeku Edmir Smajli. Po të njëjtat burime pohuan se janë në "Arrest shtëpie" farmacistja Karmen Kaçulini dhe nga administrata: Amanda Matlija, Juliana Zhuri dhe Albana Mehmetaj. Momentalisht, të arrestuarit dhe të shpallurit në kërkim dhe në "Arrest shtëpie" janë pezulluar nga detyra.

PROKURORIA

Sipas prokurorisë, këta shtetas në kundërshtim me detyrën i kanë kërkuar Ministrisë së Shëndetësisë materiale të domosdoshme mjekësore për kabinetin e Hemodinamikës. Organi i akuzës sqaroi djë se këta shtetas në shkelje të ligjit kanë kërkuar për blerje-tenderim, për periudhën kohore të mbetur të vitit 2016, pra, shtator-dhjetor 2016, një sasi shumë të madhe 400 standash (kateter, koronare dhe sete kirurgjikale të kardiokirurgjisë) jashtë çdo kriteri, apo kapaciteti që ky spital ka. Nga verifikimet e kryera rezultoi se për vitin 2016 janë lidhur 6 kontrata për blerje barnash dhe materiale për kabinetin e Hemodinamikës, shërbimi i kardiologjisë, me një vlerë prej 34 492 870 lekësh, përfshi këtu edhe kontratat për mirëmbajtjen e materialeve të blera. "Ky spital nuk ka pasur asnjë mundësi akomodimi dhe resurse njerëzore, mjek etj., të realizonte kaq shumë ndërhyrje sa stenda, e materiale të tjera që ka blerë", thuhet në njoftimin zyrtar të prokurorisë. Ndërkohë, mësohet se për këtë periudhë kohore, ky spital ka realizuar vetëm 3 ndërhyrje. Ndërsa në magazinë kanë qenë nga 2016-ta, 397 stenda. Në 2017-ën, spitali ka lidhur edhe 6 kontrata të tjera për blerje të njëjta

"Furtunë" në spitalin e Shkodrës, arrestohen ish-drejtori Përparim Çela dhe 6 bluza të bardha

Në kërkim, ish-drejtoresha Dhurata Uruçi dhe mjeku Edmir Smajli



Ish-drejtori i spitalit të Shkodrës, Përparim Çela



Ish-drejtoresha e spitalit të Shkodrës, Dhurata Uruçi



Mjeku Luan Dragusha

KUSH ESHTË MJEKU LUAN DRAGUSHA

Në njoftimin zyrtar të prokurorisë bëhet me dije se një prej mjekëve të arrestuar është dhe kardiologu Luan Dragusha. Ky i fundit u bë i njohur në media vitin që kaloi, pasi zgjodhi të kthehej nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës për t'u shërbyer qytetarëve të Shkodrës. Pas kthimit të tij në Shqipëri, 120 pacientë kanë marrë shërbimin e koronarografisë. Ndaj mjekut Luan Dragusha është vendosur masa e sigurisë "Arrest me burg" si edhe e pezullimit nga detyra.

prej 700 standash me një vlerë prej 23 milionë lekësh duke mos marrë parasysh gjendjen e stokut, afatin e skadencës, kapacitetin e spitalit, ndërhyrjet e planifikuara për atë vit etj. Ministria e Shëndetësisë ka pranuar kërkesën e spitalit të Shkodrës duke bërë kontratat përkatëse. Po sipas prokurorisë, shtetasit: Edi Smajli, Renato Kepi, Jul-

jana Zhuri, Amanda Matlija, Albana Mehmetaj me detyrë anëtarë të komisionit të marrjes në dorëzim, kolaudimit, rezultoi se kanë marrë në dorëzim medikamentet për repartin e Hemodinamikës në kundërshtim me kushtet e kontratave të lidhura në vitin 2016-2017, ndaj edhe për këtë arsye ndaj këtyre 9 shtetasve janë lëshuar flet-arrestet.

PUNONJESIT E ARRESTUAR

- 1-Arrest burg si dhe "Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik" për Përparim Çela, mjek (caktuar dhe ekzekutuar)
- 2-Arrest me burg dhe "Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik" Dh.U (shpallur në kërkim)
- 3-Arrest me burg dhe "Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik" për Luan Dragusha mjek (caktuar dhe ekzekutuar)
- 4-Arrest shtëpie dhe "Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik" për Karmen Kaçulini farmacist (caktuar dhe ekzekutuar)
- 5-Arrest me burg dhe "Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik" për Renato Kepi, infermier te Hemodinamika (caktuar dhe ekzekutuar)
- 6-Arrest me burg dhe "Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik" për E.S. mjek (shpallur në kërkim)
- 7-Arrest shtëpie dhe "Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik" për Amanda Matlija (caktuar dhe ekzekutuar)
- 8-Arrest shtëpie dhe "Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik" për Juliana Zhuri (caktuar dhe ekzekutuar)
- 9-Arrest shtëpie dhe "Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik" për Albana Mehmetaj (caktuar dhe ekzekutuar).

"Akti i paprecedent, prokuroria të rishikojë vendimin"

Arrestimi i mjekëve, protestojnë kolegët: Të lirohen, Shkodra është në emergjencë mjekësore

SHKODER - Një ditë pas arrestimeve në spitalin e Shkodrës, ka reaguuar komisioni mjekësor në këtë institucion. Përmes një deklarata për shtyp ata e quajnë një akt të paprecedent arrestimin e bluzave të bardha. Mjeku Gëzim Galiqi duke folur edhe në emër të kolegëve tha se komisioni mjekësor konteston masën ekstreme të arrestimit të personelit të spitalit të Shkodrës. Ky komision i kërkon prokurorisë të rishikojë masat e marra për faktin se bluzat e bardha të ndaluar për-

faqësojnë figura të rëndësishme në sistemin shëndetësor të Shkodrës duke mbuluar shërbime shëndetësore si hemodinamika dhe ndërhyrjet invasive për sëmundje të rënda të zemrës që rrezikojnë jetët e pacientëve si infarkti i zemrës. Të gjithë këta pacientë pas arrestimeve janë të pambuluar në shërbimin e hemodinamikës dhe kardiologjisë. Në kushtet edhe të mungesës së mjekëve specialistë vijon deklarata, mungesa e specialistëve të ndaluar është e pazvëndësueshme. Më tej në deklarata thuhet se "Në

sistemin shëndetësor krejtësisht të vertikalizuar asnjë vendim financiar nuk merret pa u konsultuar me institucionin e linjës ndaj edhe vëmë në dyshim protagonizmin e bluzave të bardha. Aksioni i komisionit do vijojë të përshkallëzohet në ruajtje të figurës së mjekut tashmë të nëpërkëmbur". Mjeku Galiqi tha se kolegët e tij janë të fundit që kanë përgjegjësi, sepse blerjet dhe tenderët bëhen nga vetë ministria dhe se mjekët si pjesë e komisioneve të ndryshme firmosin në të mirë të institucionit. Nga ana tjetër,



mjeku Luan Bajri tha se është e vërtetë që në 2016 janë përdorur te hemodinamika vetëm 3 stenda që janë unaza për zgjerimin e enëve të gjakut, por të mos harrojmë vijoi më tej se në atë vit ky shërbim bëhej për herë të parë në një qytet jashtë Tiranës dhe se për stafin atëherë ishte një sfidë. Më pas ndërhyrjet janë shpeshuar tha mjeku Bajri duke bërë të

ditura edhe shifrat. Në 2017 janë përdorur 42 stenda dhe këtë vit deri tani janë përdorur 24 stenda. Sa i përket stokut, mjeku Bajri u shpreh se kjo nuk është përgjegjësi e bluzave të bardha, por është një rakordim mes farmacistë dhe ministrisë dhe se mjekët nuk kanë djepi për gjendjen në magazina, por thjeshtë bëjnë kërkesat vjetore që kanë.

Ambasada amerikane: Si bëhet bashkimi familjar

Vizat emigruese në SHBA, ku duhet të drejtoheni për intervistën

Të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të jetojnë e punojnë në tokën e premtuar, duhet të drejtohen pranë Qendrës Kombëtare të Vizave për caktimin e intervistës. Ky njoftim është bërë ditën e djeshme nga ambasada amerikane në Tiranë e cila thekson se Shërbimet e Nënshetitësisë dhe Imigracionit (USCIS) do të shqyrtojnë peticionet. "I Keni pyetje rreth peticioneve të vizave emigruese? Është e rëndësishme të dini se Shërbimet e Nënshetitësisë dhe Imigracionit (USCIS) shqyrtojnë peticionet, ndërsa Qendra Kombëtare e Vizave (NVC) cakton ta-

kimet për intervistë, ndaj ju duhet t'u drejtoheni atyre me pyetje tuaja rreth peticioneve në pritje për t'u bërë aktuale, apo për datë interviste. Gjithsesi, nëse thjesht dëshironi të pyesni se si funksionon procesi, unë jam këtu për t'ju ndihmuar!" - theksohet në njoftimin e ambasadës.

BASHKIMI FAMILJAR

Dy kategoritë e grupeve të Vizave që përfitohen nga familja, të afërmit e men-

jehershëm dhe preferencat familjare, janë dhënë sipas dispozitave të ligjit të imigracionit të Shteteve të Bashkuara. Për të aplikuar për një vizë imigrimi për një të afërm të menjëhershëm ose preferencë familjare, kandidatët duhet të ndjekin hapat në faqen në us visas.state.gov. Vizat Imigruese Bazuar në Familjarë të Drejtpërdrejtë bazohen në një lidhje të ngushtë familjare me një qytetar amerikan, që për-

caktohen si i afërm i drejtpërdrejtë (Immediate Relative - IR). Numri i imigrantëve në këto kategori nuk kufizohet për secilin vit fiskal. Llojet e vizave bazuar në të afërmit të menjëhershëm përfshijnë: IR-1: Bashkëshort/e e Qytetarit Amerikan; IR-2: Fëmijë nën moshën 21 vjeç i qytetarit amerikan; IR-3: Jetim i bërësuar jashtë SHBA nga një qytetar amerikan; IR-4: Jetim që do të birësohet në SHBA nga një



qytetar amerikan; IR-5: Prind i një qytetari amerikan, i cili është të paktën 21 vjeç. Ndërkohë vizat Imigruese Bazuar në Preferencën Familjare (Të Limituarit) janë për lidhjet familjare më specifike, më të largëta, me një qytetar amerikan dhe disa lidhje të përcaktuara me Banorin e Përhershëm të Ligjshëm (LPR).

Kancelarja: Ligji i ri do të shoqërohet me një paketë prej 4 miliardë eurosh

Voltiza Duro

Gjermania hap dyert për shqiptarët, një milion vende pune vakante

Angela Merkel: Do të lehtësohen procedurat e emigracionit

Gjermania do të vijojë me lehtësimin e procedurave për tërheqjen e forcës punëtore, nga e cila do të përfitojnë edhe shqiptarët e kosovarët. "Gjermania dhe Shqipëria kanë hedhur një hap të rëndësishëm drejt emigracionit legal, ku shumë të rinj dhe të reja, që kanë një arsimin profesional, tashmë mund ta gjejnë veten në tregun e ofertë-kërkesës në shtetin gjerman. Ky hap konsiderohet i rëndësishëm për vetë faktin se kjo strategji frenon punën në të zehtë nga njëra anë, ndërsa në krahun tjetër ndihmon shumë shqiptarë, që zotërojnë një diplomë të arsimit profesional", shkruan observatorioitaliano.org. Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Shqipërisë dhe Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), mbi projektin "Këshilla për Migracionin në Shqipëri", synon të forcojë kontributin e emigrantëve për vendin e origjinës, por dhe një metodë frenimi për emigrantët e paligjshëm. Kancelarja gjermane, Angela Merkel kërkon të ndryshojë fluksin migrator në vend nëpërmjet një ligji të ri për migracionin, me qëllimin e vetëm për ta bërë më të lehtë për të huajt që të gjejnë një punë në Gjermani. "Ligji i ri i emigracionit do të shoqërohet me një paketë 4 miliardë euro. Një ndër arsyt kryesore të kësaj politike duket se është nevoja e pashmangshme për të mbushur vendet vakante në sektorët kyç, si ai i kujdesit shëndetësor. Bëhet fjalë për më shumë se 1 milion vende pune vakante, shprehën përfaqësuesit e biznesit në vend. Ne do të vazhdojmë të mbështetem në profesionistët e huaj"-deklaroi Angela Merkel në Bundestagun gjerman, duke mbrojtur kështu politikat e saj pro emigracionit. Sipas saj, kompanitë nuk duhet të ikin nga Gjermania vetëm se s'po gjejnë dot staf.



Foto ilustruese

PUNËSIMI I SHQIPTARËVE

Shqiptarët ndërkohë duket se janë në fokus të ligjit të ri për shkak të potencialit që ofrojnë në sektorin e kujdesit shëndetësor. Sipas ministrit të

Shëndetësisë, Jens Spahn, të rinjtë nga Shqipëria dhe Kosova mund të ndihmojnë vendin që të mbushë 50 mijë vendet vakante në shëndetësi. Ai ndër të tjera, vetëm pak kohë më parë bënte apel për përsh-

pejtimin e procedurave për dhënie e vizave për të huajt që duan të punojnë në sektorin e kujdesit shëndetësor në Gjermani. Në 15 vitet e ardhshme projektohet që sektori të ketë 250 mijë staf mungesë.



1 MILION VENDE PUNE

"Ligji i ri i emigracionit do të shoqërohet me një paketë 4 miliardë euro. Një ndër arsyt kryesore të kësaj politike duket se është nevoja e pashmangshme për të mbushur vendet vakante në sektorët kyç, si ai i kujdesit shëndetësor. Bëhet fjalë për më shumë se 1 milion vende pune vakante, shprehën përfaqësuesit e biznesit në vend", - deklaroi Merkel.

PUNËT NË SHËNDETËSI

Sipas ministrit të Shëndetësisë, Jens Spahn, të rinjtë nga Shqipëria dhe Kosova mund të ndihmojnë vendin që të mbushë 50 mijë vendet vakante në shëndetësi. Ai ndër të tjera, vetëm pak kohë më parë bënte apel për përshpejtimin e procedurave për dhënie e vizave për të huajt që duan të punojnë në sektorin e kujdesit shëndetësor në Gjermani.

Vetëm emigrantët mund ta mbulojnë këtë hendek. Tendencia e ikjes nga Shqipëria së punonjësve të shëndetësisë mund të rritet edhe më shumë me ligjin e ri gjerman dhe nevojën në rritje për pro-

fesionistë, as politikat e reja të qeverisë për të stimuluar ekonomikisht mjekët që punojnë në rrethe, nuk kanë pasur efekt në zhbërjen e dëshirës për t'u larguar nga vendi.

Gjobiten 12 subjekte në vlerën 1.5 milionë lekë

Nis kontrolli i imtësishëm i barnave në çdo farmaci

kushteve higjieno-sanitare, kontrollin e barnave mbi pullën e sigurisë, kontrollin për tregtimin e barnave pa recetën e mjekut, etj.

Grupi i punës, i cili ka në përbërje specialistë të Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të Barnave, Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ur-

dhit të Farmacistëve të Shqipërisë do të ushtrojë kontrole të imtësishme në çdo subjekt farmaceutik që ushtron aktivitetin në Republikën e Shqipërisë, me synim garantimin e sigurisë së tregtimit të barnave për qytetarët. Në ditët e para të funksionimit të kësaj Task-Force ndërinstitu-

cionale, janë kontrolluar 21 subjekte farmaceutike dhe janë konstatuar shkelje ne 12 subjekte të cilat janë ndëshkuar me masë administrative 1.500.000 lekë për mosrespektim të kushteve të ruajtjes së barnave, për tregtim të barnave pa pullën e sigurisë dhe tregtim të barnave pa recetën e mjekut.



Me një urdhër të posaçëm, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu ka ngritur një grup të përbashkët kontrolli, me përfaqësues të disa institucioneve, ku për herë të parë përfshihen dhe inspektorët të Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë. Ngritja e kësaj Task-Force ka për synim kontrollin në çdo farmaci të plotësisht të kushteve të ruajtjes dhe monitorimit të barnave, të

Presidenti kosovar: Kufiri me Serbinë është 430 km, unë s'ju pengoj

Pamela Aliaj

Pas deklaratave të fundit të bëra nga kryeministri i Kosovës, i cili theksoi dje në një emision se shkëmbimi ose ndarja e Kosovës con në luftë, ka reaguar presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, i është përgjigjur kryeministrit Ramush Haradinaj. Presidenti i tha Haradinajt "nëse do luftë, nisja, por jo në studio televizive". Këto deklarata presidenti Thaçi i bëri gjatë takimit që e pati dje me kreun e PDSH-së së Maqedonisë Menduh Thaçi. Duke komentuar deklaratat e kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, që ka thënë se kufijtë janë bërë me luftë, Thaçi tha se cilido mund t'ia nisë luftës dhe se nuk e ka ndërmend t'i pengojë. Por Thaçi i dërgoi një mesazh, duke i thënë se lufta bëhet në istikame, jo në studio televizive. "Ata që po flasin për luftëra, unë nuk jam duke i penguar: kush të ketë qejf le t'ia nisë kur të dojë. Janë 430 kilometra në kufirin me Serbinë. Udhë e hajrit ju qoftë! Le të shkojnë! Lufta nuk zhvillohet në studio televizive, por në istikame", tha presidenti Thaçi. Pas një takimi që kishte me kreun e PDSH-së, Menduh Thaçi, presidenti i Kosovës tha se e mbështesin Maqedoninë në referendum dhe se kjo nuk është ndërhyrje. Presidenti ka shpjeguar se është udhëheqës i delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në

Thaçi reagon ndaj Haradinajt: Nise luftën, por jo në televizion

Ndryshimi i kufijve, Spanja kundër: Precedent për Katalonjën



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi

HASHIM THAÇI

"Ata që po flasin për luftëra, unë nuk jam duke i penguar: kush të ketë qejf le t'ia nisë kur të dojë. Janë 430 kilometra në kufirin me Serbinë. Udhë e hajrit ju qoftë! Le të shkojnë! Lufta nuk zhvillohet në studio televizive, por në istikame", tha presidenti Thaçi.

punimet e asamblesë së përgjithshme të OPKB-së dhe se do respektojnë gjithë axhendën dhe protokollin. Ai deklaroi se do takohet me presi-

dentin Trump dhe do të bisedojnë shkurt për çështjet aktuale në Kosovë dhe rajon. Thaçi u shpreh se Kuvendi po vonohet me nxjerrjen e një rezolute

që do të jepte një mbështetje të plotë të iniciativës për bashkëngjitetin e Luginës. Sipas tij, nëse kjo ndodh do të sjellë edhe më shumë paqe. Ndërkaq për sa i përket njohjes së pavarësisë së Kosovës, një tjetër vend ka reaguar ditën e djeshme. Ka qenë pikërisht Spanja, e cila deklarohet pro njohjes së Kosovës, në rast të arritjes së një marrëveshjeje me Serbinë, por thotë se është kundër ndryshimit të kufijve. Mediat spanjolle shkruajnë se në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Spanjës janë njoftuar në detaje lidhur me ecurinë e dialogut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë, dhe pritet që një marrëveshje historike ndërmjet dy vendeve të arrihet brenda katër apo gjashtë muajsh. Po sipas të njëjtave burime, Spanja është kundër idesë së propozuar për ndryshim të kufijve, pasi argumentojnë se një gjë e tillë mund të

Gjuriç ankohet te BE: Vetëm çizmet i vendosin kufijtë

Marko Gjuriç, drejtori i të Mashtuquajturës "Zyra për Kosovën" në Serbi, në një konferencë për mediat ka komentuar deklaratat e kryeministrit të Kosovës Ramush Haradinaj për kufijtë. Ky i fundit theksoi se "Vetëm çizmet i vendosin kufijtë". Gjuriç i është drejtuar me pyetje publike për Bashkimin Evropian, ndërsa shtoi se kjo nuk është hera e parë që vijnë nga Kosova kërcënime të tilla. Gjuriç ka drejtuar kritikë drejt BE-së, për siç ka thënë ai, heshjen e tyre përballë këtyre deklaratimeve të Haradinajt për kufijtë.



përdoret si precedent nga nacionalistët në Katalonjë, të cilët mund të kërkojnë njohje ndërkombëtare më vonë. Mediat citojnë ministrin e Jashtëm, Borell të ketë thënë se në rast të arritjes së një marrëveshje-

je ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, atëherë edhe vendet të cilat nuk e kanë njohur Republikën e Kosovës si shtet, do të lëvizin përpara për të marrë një vendim përfundimtar për njohje.



**Universiteti
Europian i
Tiranës**

maiora premunt / gjëra të mëdha na presin

ZGJIDH UET NË RAUNDIN E DYTË 15-20 SHTATOR
DP/DIPLOMË PROFESIONALE/ 2018-2019

Kontabilitet

Menaxhim

Turizëm

Dizajn i Aplikuar dhe Modë

Aplikime Informatike

Këtë vit akademik hapen për herë të parë në UET Diplomë Profesionale.

Zgjidh një universitet të madh për të hyrë në botën e profesioneve

DP - DIPLOMË PROFESIONALE / BA - BACHELOR / MP - MASTER PROFESIONAL / MSH - MASTER I SHKENCAVE / ME - MASTER EKZEKUTIV / PINT - PROGRAME TË INTEGRUARA / DR - DOKTORATURË

FAKULTETI
I EKONOMISË
BIZNESIT
DHE ZHVILLIMIT

FAKULTETI SHKENCAVE
JURIDIKE, POLITIKE DHE
MARRËDHËNIEVE
NDËRKOMBËTARE

FAKULTETI
I SHKENCAVE HUMANE
EDUKIMIT DHE
ARTEVE LIBERALE

FAKULTETI
I INXHINIERISË
INFORMATIKËS
DHE ARKITEKTURËS

FAKULTETI
I SHKENCAVE
MJEKËSORE
TEKNIKE

DEPRESIONI, NJIHUNI ME SIMPTOMAT FIZIKE

SUMMER

pages

SUPLEMENT I GAZETIA SHQIPTARE

E premtë 21 Shtator 2018



Diçka e madhe po vjen! Vildane Zeneli në skena erotike me Tunën



Elvana Gjata publikon foton gazmore në fshat

BULEVARDI POLITIK



- Arben Ahmetaj "shikon filxhanin" në Kuvend
- Fjalimi më i qartë i Ndokës: Mendo pozitivisht dhe "sakrifiko" ...
- Politikanët shqiptarë fillojnë me halucinacionet!
- Njëri me kambale, tjetri me atlete, kritika Thaçit e Haradinajt



Grupet do konkurrojnë për pesë çmime, zbuloni emocionet e netëve

"BALLKANIKA FOLK FESTIVAL"

sjell traditën e 11 shteteve në Shqipëri

Ja surprizat që kanë rezervuar organizatorët



Grupet do konkurrojnë për pesë çmime, zbuloni emocionet e netëve

Egla Xhemali

"Ballkanika Folk Festival"

sjell traditën e 11 shteteve në Shqipëri


Ja surprizat që kanë rezervuar organizatorët

E premtja është një ditë e rëndësishme për të gjithë publikun që e do artin. Gjithçka është gati. Sot starton festivali gjigant "Ballkanika Folk Festival", që vjen për herë të parë në Shqipëri. Produksioni i Sokol Gugës në të cilin do marrin pjesë njëmbëdhjetë shtete që do jenë përballë me njëri-tjetrin vjen për herë të parë në disiplinën e vallës tradicionale. Pjesëmarrësit kanë mbërritur dhe janë gati për t'u sfiduar nga shtetet e tjera për dy net. Energjia e festivalit ndihet kudo. Grupet dhuruan emocione që preken qiejt me performancën në qendër të Tiranës, duke bërë kështu që të kthehen të gjithë ata që ishin duke kaluar rrugës, po dhe kushdo që pati interes për ta, u afrua për t'i ndjekur. Festivali që do të drejtohet nga Klaus Bardeli dhe Ida Nurçe është konceptuar që të jetë një garë ku do të votohet nga një juri profesioniste ballkanase, që do të thotë që secili shtet do të sjellë një përfaqësues të vetin në jurinë e festivalit, ku nuk ka të drejtë të votojë për vendin e tij. Votimi do të bëhet elektronikisht, kështu që secili grup do të votojë në mënyrë elektronike 'live' në sallë, pa pasur të drejtën që të votojë për vendin e tij. Grupet do të konkurrojnë për pesë çmime, ku më i madhi prej tyre i përzgjedhur nga organizatorët do të jetë "Çmimi i Lahutës së Artë", që është simboli ballkanas më i vjetër dhe katër çmime të tjera speciale "Lahuta e Argjendtë", "Veshja më e mirë dhe origjinale", "Kërcimtarja/i më i mirë" dhe "Çmimi i produksionit". Çmimi i parë do vendoset



Diçka e madhe po vjen! Vildane Zeneli në skena erotike me Tunën

Javë më parë është konfirmuar se Seven Saraqi po vjen me një projekt të ri. Është Tuna bashkëpunëtorja e Sevenit në projektin e ri, e do të jetë një këngë mjaft ritmike. Është zbuluar, gjithashtu, se modelja që do të jetë pjesë e klipit është Vildane Zeneli. Modelja tejet seksi besohet se do të jetë protagoniste në klip dhe se do të kenë një skenë duke u puthur me Tunën në këtë klip. Projekti ende nuk ka datë lancimi, teksa xhirimet e klipit tashmë kanë filluar. Ky projekt rikthen fuqishëm Sevenin pas këngës mjaft të suksesshme me Argjentina Ramosajn. Ndërkaq, Vildane Zeneli besohet se është ende 'single' dhe së fundmi ka pasur arsye mjaft të forta të qëndrimit në Prishtinë.



Elvana Gjata publikon foton gazmore në fshat

Elvana Gjata është një nga këngëtares më të përfolura të show bizzit shqiptar. Pas angazhimeve të shumta gjatë verës ajo ka zgjedhur të pushojë disa ditë. Së fundmi ajo ka postuar në llogarinë e saj në "Instagram" një foto ku shihet pranë disa lopëve. Por ajo çka ka shkaktuar të qeshura në rrjet është përshkrimi që i ka vënë fotos. "Unë dhe shoqet e mia duke u relaksuar" ka shkruar Elvana. Para disa ditësh ajo postoi foto nga Afrika teksa lundronte me varkë, në ishullin Hakuna. Le të kujtojmë se së fundmi ajo po punon dhe për një projekt në bashkëpunim me Eremal Mamaqin dhe shumë aktorë të tjerë të famshëm shqiptarë.



'live' nga juria në mënyrë elektronike. Por, surprizat nuk kanë të ndalur. Përpos njëmbëdhjetë shteteve që do të vijnë në Shqipëri, produktioni ka menduar që të jenë pjesë e këtij festivali

edhe dy grupe të ftuarish, ansambli "Kolo" që vjen nga Bielsko-Biala në Poloni dhe ansambli arbëresh "Shqiponjat" që vjen nga Italia. Natyrisht që nuk do të mungojnë edhe të ftuarit spe-

cialë nga Shqipëria, por jo të gjitha do të zbulohen. Nuk do të mungojë as ansambli mirditor, që do të luajë për kënaqësinë e të gjithë të pranishmëve. Do të ketë muzikë me çifteli, meqë edhe jemi

në vitin e Skënderbeut. Këto kohë është punuar fort që gjithçka të jetë e kurrar deri në detaje. Emocionet e natës së parë të konkurrentëve do i zbehë skena. Nuk do e ekzagjeronim nëse do thoshim që ky

superfestival do ngelet gjatë në histori, pasi përkon edhe me vitin e Skënderbeut dhe se çdo gjë është mirëmenduar për t'i qëndruar me fanatizëm traditës, duke na bërë krenarë.

Arben Ahmetaj "shikon filxhanin" në Kuvend

Kryeministri Edi Rama është shfaqur i zymtë në Kuvend, ndërsa ministri i Financave, Arben Ahmetaj ka shkuar në Kuvend me një filxhan kafeje. Seanca e djeshme në Kuvend u zhvillua sërish pa praninë e opozitës.

Në një moment, shkrepur nga LSA, Ahmetaj shihet teksa shikon filxhanin dhe batutat e rrjetit s'mungojnë ku thuhet: "Ahmetaj shikon në filxhan financat e shqiptarëve" ose "Ahmetaj shikon filxhanin".



Fjalimi më i qartë i Ndokës: Mendo pozitivisht dhe "sakrificko"...

Sikur nuk mjaftojnë batutat e stisura në rrjetet sociale për të, dhe Sai, Nard Ndoka vazhdon të na jap edhe më shumë materiale. Kështu, "reality-show" i Nard Ndokës ka vazhduar edhe në tubimin e hapjes së fushatës zgjedhore të Partisë Demokratike të Shqipërisë. I emocionuar dhe duke ju dridhur zëri, Nard Ndoka mezi ka arritur të përfundojë së lexuari fjalimin e shkurtër të shoqëruar me shumë gabime e ngatërresa fjalësh, ndërsa është duartrokatur fuqishëm nga të pranishmit.



BULEVARDI POLITIK

Në merrni seriozisht! 😊



Politikanët shqiptarë fillojnë me halucinacionet!

Me t'u afruar zgjedhjet në Maqedoni vihet re shti mi i ëndrrave me sy hapur dhe halucinacioneve të politikanëve shqiptarë në Maqedoni. Më i ndikuari ka qenë Menduh Thaçi, i cili "ua ka hedhur" dy kundërshtarëve të tij, Ahmeti dhe Osmani, me imagjinatën e avancuar. Imagjinata e tij shkoi deri aty saqë, jo vetëm që deklaroi pak vite më parë që do të fitojë (që është e normale dhe e mundshme), por ka shtuar se do të fshijë nga faqja e dheut partitë tjera duke i mposhtur me rezultat të thellë 6-0. Kjo është një histori imagjinare, në fakt.



Njëri me kambale, tjetri me atlete, kritika Thaçit e Haradinajt

Ramush Haradinaj dhe Hashim Thaçi janë figurat më të rëndësishme të politikës së Kosovës. Kryeministri Haradinaj ka qenë i ftuar mbrëmjen e së mërkurës në TV Klan. Ajo çka është vënë re nga shikuesit janë kamballet që Haradinaj kish veshur në emision, që në pamje të parë duken si çizme, aq të mëdha janë. Por edhe Hashim Thaçi, i cili ka qenë i ftuar në po të njëjtin emision ka rënë në sy për të njëjtin aksesori, vetëm se në ndryshim nga kryeministri ai kishte veshur atlete të zeza me smoking. Këto dy foto kanë qenë të postuar në 'Instagram' dhe kanë qenë të shumtë njerëzit që i kritikonin dy liderët kosovarë për veshjen.



VRASJA E MINISTRIT IN MEMORIAM

Rezarta Delisula
Klodiana Lala

Pas një periudhe 20-vjeçare do të rikthehen në fund në atdhe eshtrat e ish-ministrit të parë të Mbrojtjes në Kosovë, Kolonel Ahmet Krasniqi. Ish-ministri i Mbrojtjes së Republikës së Kosovës, Kolonel Ahmet Krasniqi do të rivarrosset në Kosovë, më 21 shtator 2018, në 20-vjetorin e vrasjes së tij në Tiranë. Ish-ministri i Mbrojtjes së Republikës së Kosovës, Kolonel Ahmet Krasniqi, njëherësh edhe mik i ngushtë i Azem Hajdarit, është dekoruar me urdhra të lartë të të dy shteteve, "Hero i Kosovës" dhe "Urdhri Gjergj Kastrioti - Skënderbeu", për meritat e tij të veçanta dhe kontributin historik për liri dhe pavarësi. Ndërkohë që para 5 vjetësh, në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", kushëriri i kolonelit Krasniqi, Aziz Krasniqi, ka kërkuar rikthimin e eshtrave të tij në Kosovë. Për më tepër në intervistën e marsit të 2013-tës.

Ahmet Krasniqi, ish-ministër i parë i Mbrojtjes së Kosovës, ekzekutuar me 21 shtator 1998 në Tiranë në moshën 50-vjeçare, prehet në varrezat e Sharrës, shumë pranë mikut të tij Azem Hajdari. Aziz Krasniqi, kushëriri i parë i ministrit, në intervistën dhënë për "Gazetën Shqiptare", shprehet se në këtë 15-vjetor të përkujtimin të tij do kërkojnë që eshtrat e Ahmet Krasniqit të kthehen në Kosovë dhe të vendosen në varrezat e dëshmorëve. Por si ka qenë jeta e ish-ministrit në fëmijëri, rritja e tij jetim e sa ka ndikuar familja e krijuar me serben Sllobodanka në përcaktimet e ndryshme që i kanë bërë qenies së tij pas vrasjes...

Keni qenë ndonjë herë në shtëpinë e tij në Tiranë?

Sa di unë dhe jam i sigurt, Ahmet Krasniqi nuk ka pasur shtëpi personale në Tiranë. Ai ishte në Tiranë përkohësisht, por edhe në Tropojë, derisa të futej në Kosovë me batalionin "Skënderbeu".

Pas vrasjes së Krasniqit, pati më ofensiva serbe?

Pas vrasjes së tij në Tiranë, më 21 shtator 1998, në mëngjesin e 22 shtatorit, forcat serbe e bënë Zhilivodën (vendlindjen e Ahmet Krasniqit) rrafsh me tokë. Popull dhe ushtarë ishin të strehuar në Qyqavicë, pikërisht familja ime u gjind në vendin e quajtur Qeshmija e Djefci.

Pse nuk i interesonte politikës Kosovare të kishte në qeveri një burrë si Ahmet Krasniqi?

Sepse ishte lufta për pushtet, sepse ishin përçarjet pikërisht sikur në kohën e Jusuf Gërvallës. Sepse gjatë luftës mbretëronte një atmosferë vëllavrasëse m'u sikur pas

Vritet 20 vjet më parë, rivarrosset sot Kolonel Ahmet Krasniqi

Ekzekutimi i ish-ministrit, familja: Të sillet në Kosovë si hero



HAPJA E DOSJES

Shoqata humanitare "Sali Çekaj", në Zvicër e Gjermani përmes një peticioni të nisur kryeministrit të Kosovës, atij shqiptar, kreut të EULEX, BE... kërkojnë të gjenden përgjegjësit për vrasjet politike të ministrit të Mbrojtjes të Republikës së Kosovës, kolonel Ahmet Krasniqi, Ali Ukaj, kolonel Tahir Zemaj, Ilir Konushevc, Xhemali Mustafa, Shaban Manaj, Bardhyl Ajeti, Smail Hajdaraj, e gjithë të tjerët...

Mbledhjes së Mukjes dhe kjo gjendje vazhdoi edhe pas luftës që, gjithashtu, janë të dhimbshme.

Vrasësit e tij janë identifikuar dy shqiptarë që përdorin dialektin e Kosovës, dini gjë për fatin e tyre, njërin kemi lexuar se është vrarë?

Besoj që për këtë pyetje jam përgjigjur në pyetjen e mësipërme. Sikur të dinim dhe të ishim të sigurt nga ajo që thuhet në net, sigurisht që

do t'iu bënim padinë në gjyq. Emri dhe mbiemri i të vrarit gjendet në faqen e (FB) të Ahmet Krasniqit. Por, atë emër e shkroi nofka Arvan Arvanitas. Sa mund t'i besohet një nofke?

Kë akuzoni për vrasjen e tij?

Kjo çështje është aq shumë e koklavitur sa s'mund t'i vesh gishtin askujt. Për këtë kemi kërkuar nga drejtësia shqiptare të hapë dosjen e Ahmet Krasniqit për t'u gjetur vrasësit, ose të na thonë nëse kjo është vazhdimësi e persekutimit të fisit tonë nga ai rrjeti enverist si Haziz Zhilivodës e ministrit Krasniqi. Eshhtë thënë se kanë qenë 3 vetë në atë atentat ka qenë nga Shqipëria e pesë nga Kosova. Pse nuk jepen emrat e tyre, të denohen, por i duhet të mbajë në ndërgjegje peshën e vrasjes së Ahmetit.

Komandanti ka lënë gruan Sllobodankën, vajzën Teutën e një djalë Florentin. Ku jetojnë ata tani, me se merren, sa shpesh i takoni?

Gruaja jeton në Rovinje ndërsa fëmijët në Zagreb. Djali i vjen shpesh në Kosovë d.m.th. takohemi 4 apo 5 herë në vit.

Po bashkeshortja e Ahmetit, Sllobodanka është kroatë?

Është serbe, por dihet fakti që në atë kohë të kryesh aka-

KUSHËRIRI I AHMET KRASNIQIT

"Mund të ketë lidhje me vrasjen e Azem Hajdarit, por ne nuk dimë asgjë në këtë drejtim. Sipas asaj që dihet, pas një darke pune në restorantin 'Nëna mbretëreshë', nga restoranti dalin 3 automjete dhe rrugës i ndal policia shqiptare e maskuar, dy i lëshon, por ua ndërron drejtimin, ndërsa automjeti ku gjendej Ahmet Krasniqi niset në drejtim të banesës ku banonte".

deminë ushtarake dhe me marrë gruan shqiptare ka qenë shumë e vështirë.

Ka ndikuar gruaja e tij që dila e quajnë jugosllav?

Po çfarë lidhje ka gruaja. Edhe Ismail Qemali gruan e kishte bullgare, por vetë ishte shqiptar. Vrasja e Ahmet Krasniqit ka qenë vrasja më e madhe pas Hasan Prishtinës dhe ngjashme me vrasjen e anëtari të qeverisë së Ismail Qemalit Mehmet Pashë Durrani. Fatkeqësisht këtu përsëritet historia, për shkak se ende ka njerëz që kanë pas propagandën e propagandojnë kundër popullit shqiptar.

Mund të na tregoni copëza kujtimesh tuaja personale me të ndjerin ministër?

Viti nuk më kujtohet kur e ka qenë në familje, por besoj diku rreth vitit 1989-1990, po në atë kohë isha në shoqërinë kulturo artistike "Jusuf Gërvalla" dhe Ahmeti më tha: Këndoja Bacit një këngë me çifteli! Ja këndova këngën "Moj Serbi shtrigë e vjetër", kur përfundova më tha: Të këndoftë zemra e rrofs, Aziz Zhilivoda i vogël!

Kur ia këndove këngën Ahmeti erdhi në shtëpinë tuaj?

Ishim në odën e axhës Ragic, kështu që shtëpia jonë ka qenë e përbashkët.

Po gjyshi juaj ku jetonte dhe pse u dënua?

Jetonte në Elbasan dhe u dënua me 10 vjet burg me akuzën se kishte bërë propagandë kundër pushtetit të atëherëshëm enverist dhe mbronte shokët e tij patriotë nga Kosova.

Ahmet Krasniqi është varrosur afër Azem Hajdarit në Tiranë, a njihet me të?

Po Azem Hajdari dhe Ahmet Krasniqi njiheshin mirë, sepse Azem Hajdari ka qenë mbështetës i fortë i çlirimit të Kosovës.

Mos kanë lidhje dy vrasjet bashkë?

Mund të ketë lidhje, por ne nuk dimë asgjë në këtë drejtim. Sipas asaj që dihet, pas një darke pune, në restorantin "Nëna mbretëreshë", nga restoranti dalin 3 automjete dhe rrugës i ndal policia shqiptare e maskuar, dy i lëshon, por ua ndërron drejtimin, ndërsa automjeti ku gjendej Ahmet Krasniqi niset në drejtim të banesës ku banonte.

Me kë ka qenë Ahmet Krasniqi kur është vrarë?

Drejtues i automjetit ka qenë Naim Geci dhe një gazetar oficer Rifat Haxhijaj të dy jetojnë në Zvicër. Shpjegimin e vrasjes nuk e kanë bërë asnjëherë publikisht.

Ramush Haradinaj dhe Hashim Thaçi kanë pas njohje me Ahmetin?

Hashim Thaçin e di se ka pas njohje, ndërsa për Ramushin s'mund të them se nuk e di.

Tani meqë bëhen 15 vjet nga vdekja e tij, do i kërkojnë eshtrat e tij për t'i bërë në rivarrim, siç i takon?

Sigurisht që ne dëshirojmë shumë të kthejmë eshtrat e Ahmet Krasniqit në Kosovë, por duam ta bëjmë këtë institucionalisht, sepse ashtu i takon. Kemi kërkuar për një vend në varrezat e dëshmorëve nga Isa Mustafa dhe ai ka premtuar se do e bëjë të mundur, por ka thënë që kjo do punë. Por ne do kërkojmë non stop të sillen eshtrat e tij në Kosovë ashtu, siç i takon. Ndërkaq që duam të sjellim në Kosovë edhe eshtrat e gjyshit Haziz Zhilivodës, i cili ndodhet i varrosur në Elbasan.

Ijemi drejtuar institucioneve shqiptare për hapjen e dosjes?

Po, Bexhet Krasniqi, vëllai i Ahmetit, ka kërkuar të hapet dosja dhe i kanë thënë që të gjej një avokat të fortë për të ndjekur këtë çështje. Por se kuptojmë pse për një vrasje të një niveli kaq të lartë duhet të merremi neme avokatë, eshtrë shqiptar ku i krye vrasja nuk përpigjet të zbardhë çështjen e të gjejë fajtorët.

VITI I SKENDERBEUT

AKADEMIA E SHKENCAVE

Plasari e Nadin marrin çmim për Skënderbeun, Rama: Të vijojë reforma

Fatmira Nikolli

Është mbajtur dje në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, ceremonia e dhënies së Çmimit Shkencor për Gjergj Kastriotin – Skënderbeun dhe epokën e tij, veprës më të mirë shkencore nga autorë shqiptarë dhe autorë të huaj, në kuadër të Vitit Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit – Skënderbeut. Veç akademikëve e studiuesve, i pranishëm në ceremoni ishte edhe kryeministri Edi Rama dhe ministrja e Arsimit Lindita Nikolla. Duket se mes Akademisë dhe qeverisë debatet e nisura një vit më parë që deshin në shkryerjen e institucionit të lartë shkencor, pas ndërhyrjes së akademikut Artan Fuga dhe statuseve të rrepta të kryeministrit, janë shuar. Akademia e mbetur pa kryetar dhe në proces reformimi, ka gjetur paqe me qeverinë dhe tanimë, prania e kryeministrit në radhën e parë përshëndetet me përzemërsi disa herë, sikundër falënderohet për fondet e akorduara dhe vëmendjen në kohët e vështira. Duket, se Akademia është dorëzuar. Por kryeministri i pranishëm në ceremoni në fjalën e mbajtur, edhe pse shprehet se nuk është aty për të orientuar, nuk lë jashtë vëmendjen reformën. Ai theksoi rëndësinë që duhet të ketë Akademia e Shkencave për elitën dhe shoqërinë shqiptare dhe shtoi se Shqipëria është vendi i fundit në rajon për përfitimin e fondeve europiane për kërkime shkencore.

RAMA PËR REFORMËN

Në fjalën e mbajtur nga kryeministri u kujtua se veprimtaria e djeshme duhet të mbahej me shumë mirënjohje, për organizatorët dhe autorët. "Duhet të nxjerrim në pah veprat dhe autorët e tyre për të dhënë një shenjë kuptimplotë, pavarësisht varfërisë që ka pllakosur në të gjithë terrenin e veprimtarive publike, për veprat dhe cilësitë e tyre", tha ai, pa harruar të përmendë reformën. "Për sa i përket reformimit të Akademisë së

Shkencave, më në fund gjërat u vunë në një lëvizje të vonuar. Më vjen shumë mirë që sot që flasim jemi përballë një pune të kryer me zell dhe përgjegjësi nga grupi i ngritur për këtë reformë, nën drejtimin e profesor (Skënder) Gjinushit. Por jemi strikt proceduralisht, po të cenim para pa u ndalur asnjë sekondë me tekstin e sjellë nga grupi i punës. Të ndalem një sekondë dhe të nxisim një ballafaqim mes dy alternativave. Mbase në platformën e grupit të punës gjithçka është siç duhet, por mbase në platformën alternative, ka gjëra që duhen marrë në konsideratë. Ndaj unë mendoj se janë gjëra që s'duhet t'i them unë", -u shpreh kryeministri. Ai kërkoi dhe madje e cilësoi të rëndësishme që "askush të mos paragjykojë rezultatit për shkak se njëra platformë kishte mbështetjen e qeverisë, ndërsa tjetra jo. Nga kjo, fiton procesi dhe akademja për nesër. Mendoj se disa gjëra kanë marrë udhë. Duhet t'i konsolidojmë që të

Studiuesja Nadin: Përpiqem të kthej kujtesën me punën time



Aurel Plasari

kthehen në ligj nesër në Kuvend". Kryeministri tha se drafti i reformës në rastin e Akademisë së Shkencave nuk mund të jetë i imponuar nga lart, pasi duhet të jetë si domosdoshmëri për akademinë së brendshmi. "Ama, është inkurajuese që në këtë platformë ka disa elementë të kërkuar nga koha prej shumë kohësh. Gjetja e dakordësisë është një gur

themeli për të ardhmen. Dua të ngre shqetësimin shumë serioz që shprej të adresohet dhe të mos neqet "klithma" në shkretëtirë. Shqipëria, është e fundit në rajon, për ekselin në fondet evropiane për kërkimin shkencor. Serbia ka fituar 90% të projekteve që ka çuar për aplikim, ndërsa Shqipëria 4.5%. Dakord, paraja është bazë, por, nga ana tjetër, ak-

Vlerësohen "Skënderbeu politik" dhe "Shqipëria e rigjetur"



Luçia Nadin

sesi për fondet që janë në dispozicion, nuk merret me para, por me dije", tha shefi i qeverisë. **ÇMIMET E MOTIVACIONET** Më pas u mbajt ceremonia e ndarjes së çmimeve në Akademinë e Shkencave që vjen si rezultat i konkursit Shkencor Ndërkombëtar me rastin e vitit mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit

Skënderbeut. Për autorët shqiptarë fitues është shpallur studiuesi Aurel Plasari me veprën "Skënderbeu, një histori politike", ndërsa për autorët e huaj fituese është Luçia Nadin me veprën "Shqipëria e rigjetur". Këto janë përzgjedhur nga 30 vepra.


Për veprën më të suksesshme kushtuar Gjergj Kastriotit - Skënderbeut nga

Libri i Artë i Albanologjisë, Kadare: Amza e më të shquarve në studimet shqiptare

Seanca e dytë e veprimit Starisë iu kushtua paraqitjes së Librit të Artë të Meritës në Albanologji, themelimi i të cilit u bë jo rastësisht në Vitin Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit – Skënderbeut.

Libri pritet të jetë një shenjë përgjegjësie institucionale ndaj të gjitha qendrave, shkollave dhe individëve, sot, në të shkuarën e në të ardhmen, që e kanë lidhur e do ta lidhin emrin dhe jetën e tyre me botën shqiptare, me gjuhën shqipe dhe letërsinë e saj, me historinë, kulturën dhe identitetin kombëtar shqiptar. Sipas Sekretarit Shkencor Vasil Tole, personaliteti i Gjergj Kastriotit – Skënderbeut është figura që bashkoi për herë të parë shqiptarët dhe krijoi bazat e identifikimit dhe të etnodallimit të tyre. Me qëndrësën shqiptare që ai udhëhoqi,

u arrit konvergjenca e parë dhe më e rëndësishme ardhore. "Tituj nderi, vlerësimi dhe mirënjohje për albanologët e huaj dhe vendës ka jo vetëm në Shqipërinë shtetërore, por dhe në Kosovë e gjetkë. Por Libri i Artë i Meritës do të jetë mirënjohja më e lartë, banka e të dhënave me të përzgjedhura të albanologjisë. Të gjithë ata që kanë merita të përsëritshme për kontribute origjinale në albanologji do të hapin portën e meritës me autoritetin e tyre dhe do të bashkohen aty", tha Tole. Ai shtoi se Libri është hapur për studiuesit më të shquar të Mesjetës shqiptare, të shekujve të humanizmit, që i ndërlidh figura e Gjergj Kastriotit – Skënderbeut, epoka e tij dhe përmasat ballkanike e europiane që e cilësojnë. Sipas tij, kjo është arsyeja pse, siç mund të vërehet edhe nga programi, kodi



i nderit i Albanologjisë kësaj here fillon me historianët shqiptarë Aleks Buda e Kristo Frashëri, me Alen Dyse-lienë (Francë), me Peter Bartl-in dhe Franz Babinger-in (Gjermani), me Kostas Sathas-in (Greqi), me Francis Pal-in (Rumani) dhe Halil Inal-ik-un (Turqi). "Profillet e tyre intelektuale do të paraqiten nga aka-

demikë e profesorë të ftuar, si: Fran-esko Altinari, Flor-resha Dado, Pëllumb Xhufi, Aurel Plasari, Luan Malltezi, Kosta Giakumis e Ferit Duka, të cilët njëherësh do të jenë nënshkruarit e parë të zërave të përgatitit prej tyre në Librin e Artë të Albanologjisë. Sikurse mund ta shihni, ky libër nuk është thjesht një

bllok i bardhë, një libër i bardhë, por një artefakt i vërtetë. Ai me të drejtë mund të quhet kodiku i fundmë i Shqipërisë, i kësaj hapësire historike ku historia e dorëshkrimeve nis që nga shekulli VI. Është përgatitur me të gjitha kërkesat dhe me të gjitha teknologjitë manufaktuale të një kodiku, një mjeshtëri e rrallë sot, që i përgjigjet edhe nga kjo anë nivellit të lartë të dinjitetit dhe nderimit që duam të ofrojmë përmes tij", -theksoi Tole në emër të Akademisë që është ende pa kryetar. Për të, ky kodik është një kryevepër në lojin e vet, i cili na erdhni nga hapësirat arbëreshe në Itali, si një kod modern vlerash e ribashkimi mes nesh. "Dikur për të mbrojtur vendin dërgimi i armëve ishte gjëja e duhur. Sot, dhurimi i një libri është arma e duhur për ruajtjen e gjërave

Opinion i Ditës

Anti-thaçizmi si dëshmi e shterpësisë së mendimit politik në Kosovë

Nga Adri Nurellari

(vijon nga faqja 1)

... diskutojnë për ngjarjet ndër-sa mendjet e vogla diskutojnë për njerëz". Fatkeqësisht në Kosovë prej shumë vitësh dominon debati politik mbi persona e jo mbi ide e zhvillime sikurse ndodh në vende me kulturë politike më të avancuar...



skenen politike në vend gjatë muajve të fundit që po diskutohet faza finale e dialogut me Serbinë. Duke u marrë gjithmonë me sulme ndaj...

Debati publik sot është i dominuar nga sulmi kolektiv ndaj Thaçit prej opozitës i atyre përmasave që fte rrikthehte kujtimin e krijimit të VLAN-it një ditë pas ditës së votimit...

Kjo politika e mbështetur te personaliteti bën që i gjithë ligjërimi politik të reduktohet te karakteri si dhe veprimet apo mosveprimet e një personi të vetëm e mos të merret me fakte, bilance, projekte, ide apo reforma të realizuara...

Ideala do ishte që të ishin idetë ato që do të dominonin debatin politik kosovar mirëpo me sa duket duhet ende kohë që të ndrriçohet mentaliteti ynë. Nuk ka asgjë të keqe që të këtë kritikë, dyshime e kërkëse llogarie mbi një lider politik...

kjo parti ndonjë propozim, rekomandim, sugjerim e mos të flasin për platformë apo vizion konkret për përmbajtjen që do duhet të kishte marrëveshja e paqes me Serbinë, por vetëm janë marrë me presidentin. Gjithë ajo parti që krenohet me kuadrot e shkolluar...

Aktualisht ekziston një kontekst politik ndërkomëtar i favorshëm por shumë delikat e relativisht i përkohshëm që mund të sigurojë mbijlljen e konfliktit me Serbinë dhe cimentimin e subjektivitetit ndërkomëtar shtetëror të Kosovës. Ekziston një presion ndërkomëtar nga Bashkimi Europian dhe SHBA-të për ta shtyrë përpara e finalizuar sa më shpejt një marrëveshje të plotë juridikisht të obligueshme mes Kosovës dhe Serbisë...

Mirëpo aq i fortë është sentiment i anti-thaçit sa kundërsharëtarë politik, për hir të marazit të papërmbajtshëm janë të gatshëm t'i habbasin Kosovës këtë rrethanë historike vetëm për inatin e tij ose që të vepronjë në përpulje me fjalën e urtë popullore, për inat të vjehrrës më vdektë burri. Ky qëndrim absurd anti-person mund të rrezikojë që ta përshkëlqej vitin 2014 kur opozita afërshme e la Kosovën pa ushtri prej inatit kundër Thaçit...

të rezervuara për një mandat më shumë gjë që ishte kushti i partive politike parlamentare të pakicës serbe për të votuar në këmbim formimin e ushtrisë. Përfaqësia politike në parlament në zgjedhjet që pasuan ndryshoi tërësisht me përfshirjen e veriut në zgjedhje dhe krijimin e Listës Serbe dhe kreu ndryshe nga përfaqësia politike e mëherëshme, Lista u deklarua ashpër kundër ushtrisë së Kosovës...

Dominimi i anti-thaçizmit në diskursin politik në Kosovë nuk është shqetësues vetëm për cënimin e interesave shtetërore dhe humbjen e mundësive historike për vendin sikurse ndodhi me ushtrinë, por edhe për shëndetin e demokracisë në vend. Mungesa e debatit ideologjik, e përbaljes së këndvështrimeve dhe e paraqitjes së alternativave programore lë të kuptohet se jemi ende duke përjetuar një situatë para-politike apo para-moderne...

të karakterit, personalitetit, sjelljet, tiparet fizike, biografia, familja, temperamentit apo veçoritë të tij të tjera psikike. Ndërkohë që në lizhohet debati mbi temat konkrete, mbi ideologjitë, institucionet, proceset, ligjet apo reformat. Për rrjedhojë debati politik ka tendencë destruktive se synon denigrimin e kundërsharëtarin ndërkohë që do të duhej të ishte konstruktiv në formën e ballafaqimit të alternativave politike. Pra në vend që të merret me standarde e performanca institucionale përqendrohet tek sulmi ndaj një

individi si mishërimi i së keqes. Ideala për një demokraci të konsoliduar është politika e bazuar në çështje vendos në plan të parë vlerat, idetë, parimet, propozimet, reformat, politikat konkrete apo vizionin për të ardhmen. Kjo lloj politike përqendrohet mbi çështjet që ndikojnë në jetën e përditshme të qytetarëve të një vendi dhe ofron zgjidhje të adresojnë ato. Në rastin e Kosovës politika përmbajtësore e bazuar mbi çështjet do të duhej të merrej me çështjet që prekin më shumë qytetarin e Kosovës sikurse janë subjektiviteti ndërkomëtar i vendit, varfëria, papunësia, garantimi i një gjyqësori efikas dhe sundimi të ligjit, qasja në shërbime cilësore publike si arsimit e shëndetësisë, nevoja për strehim apo infrastrukturë e prapambetur. Shpesh shumë prej këtyre çështjeve mund të trajtohen në nivel të pushtetit vendor në Kosovë duke patur parasysh nivelin e lartë të decentralizimit, mirëpo fatkeqësisht edhe përfaqësuesit e pushtetit vendor në më të shumtën e rasteve merren me përplasjet personale të nivelit qendror...

Kuptohet që roli i individit në politikë është shumë i rëndësishëm e shpesh vendimtar, mjafton të shikohet roli që ka kandidati për kryeministër në Britani apo kandidati për president në SHBA për të kuptuar sa i fortë është dimensioni i personalizimit të politikës. Mirëpo kur shkohet në ekstrem dhe gjithë politika përqendrohet tek roli i individit, i bie të neglizhohen shumë aktorë, faktorë e rrethana që po ashtu luajnë rol kyç. Po ashtu duhet kuptuar që në këto dy demokraci më të vjetra të Evropës, nuk bëhet thjesht fjale për individë karizmatikë por individë me ide e propozime konkrete. Britanikët dhe amerikanët besojnë thjesht të njerëz të caktuar të famshëm por tek njerëz që besojnë e propozojnë ide të caktuara. Historia moderne e botës së zhvilluar tregon se idetë për t'u materializuar kërkojnë idealistë karizmatikë që i shtyjnë përpara këto ide. Këta individë me retorikën që përdorin, programet që shpallonin, qëndrimet që mbajnë faktikisht shndërrohen në mishërimi i ideove që pa ta do konsideroheshin thjeshtë si ide abstrakte. Pra, bëhet fjalë për politikë që janë të lidhur ngushtë me grupe të qarta idesh duke u ofruar në paketë si ofertë për ata që përkrahin këto ide...

Fatkeqësisht shqiptarët kudo që jetojnë nuk kanë pasur përvoja të demokracisë dhe në memorien kolektive njihin ose padishahun e portës së lartë ose udhëheqësin komunist të lavdishëm të tipit Enver Hoxha apo Marshall Tito. Brenda perandorisë Osmane, me përjashtim të dy periudhëve të shkurtra të monarkisë kushtetuese dhe mbledhjes së asambleës së përgjithshme përfaqësuese në 1876-78 dhe 1908 deri në luftërat ballkanike, shqiptarët nuk kanë pasur asnjë përjetim në të kaluarën të ndonjë forme qoftë rudimentare të demokracisë. Për hir të së vërtetës ajo mënyrë e të konceptuarit të jetës si një hierarki me në krye një individ drejtues shkon përnatë edhe me traditën tonë patriarkale ku fjala e babait apo të parit të familjes kishte peshën e ligjit. Në Kosovë mungesa e përvosjes së kalendarit të demokracisë dhe përqendrimi i tejskajshëm tek

Trajneri i të kuqve beson se loja e të tijve do të arrijë ku duhet në javën e shtatë



Jeton Selimi

Gega: Partizanin e vërtetë nuk e keni parë ende

Vjen Flamurtari, kryeqytetasit duan 3 pikët

Skënder Gega ka marrë përsipër një mision të vështirë. Të udhëheqë një grup të rinjsh drejt suksesit. Partizani i këtij viti ka ndryshuar format në krahasim me vitet e shkuara. Nuk ka bujë, nuk ka pompozitet dhe merkatoja ka qenë e bazuar kryesisht në lojtarët e rinj dhe të perspektivës. Natyrisht që një trajner do të kishte dëshirë për më shumë eksperiencë në ekip, por një si Gega, ku në venat e tij rrjedh gjaku i kuq, do të kërkojë t'u mësojë të gjithëve se çfarë është Partizani dhe sesi arrihet titulli, titull që në klubin kryeqytetas mungon prej 25 vitesh.

Flamurtari vjen kundër jush pas humbjes ndaj Skënderbeut

Unë besoj se është një sfidë komplet tjetër që nuk do të ketë ndoshta anë interprim në dëshirën e tyre, do e kalojnë atë moment. Në Tiranë do të vijmë me qëllim kryesor që të marrin maksimumin. Ne jemi përgatitur, e dimë forcën e Flamurtarit dhe besoj se është ekip shumë i mirë, por e dimë edhe forcën tonë, e respektojmë veten tonë dhe kemi qëllim vetëm fitoren.

Si është forma e skuadrës?

Besoj se sa mbaroi java e katërt. Ne jemi në progres. Po punohet në të gjitha drejtimet për t'u rritur. Është vetëm fillimi dhe katër ndeshjet e para e kam thënë edhe më parë që nuk e vendosin kampionatin. Nga ana fizike jemi shumë mirë, gjatë kohës, stërvitjeve mund të ketë ngacmime të vogla që ndodhin në çdo stërvitje dhe çdo klub, te Partizani bëjmë më tepër lajm, por nuk ka asgjë shqetësuese. Besoj se do të jemi të plotë në ndeshjen e nesërme.

Dakord, por ndërkohë sulmi vijon të çalojë?

Është diçka që ne e kërkojmë, që loja e futbollit e kërkon. Janë dy faza që duhet t'i bëjmë mirë, jemi munduar, nuk ka qenë absolutisht perfekt, por jemi në



rritje. Vazhdimisht i kam shpjeguar pozicionin e Hebagj, por edhe kontributin e tij. Ai nuk mund të jetë i veçant nga ekipi, nëse ekipi luan e kontribuon edhe Hebagj do të rritet. Është i ri, është 20 vjeç. Jam i sigurt që do të rritet. Gjithmonë flitet për një qendërsulmues golas-hënues. Në fakt, në futbollin e sotëm unë besoj që në mesfushë e sipër duhet të jenë të gjithë në gjendje të godasin e shënojnë, shpresojmë ta bëjnë që në ndeshjen me Flamurtarin.

Rritja që ka ekipi?

Besoj se çdo ndeshje ka sfidë dhe fytyrën e vet. Besoj se Partizani po konsolidohet, në logjikë, koncept dhe njohjen e njëri-tjetrit. Ka kaluar java e katërt dhe shumë njerëz thonë që nga java 7-8 shihen ekipet. Unë dua të marr maksimumin dhe në këtë periudhë që jemi, secilit në ekip, por edhe të tjerëve. Besoj se do të kemi javë të tjera ku do të bëjmë

më shumë, më mirë, duke filluar nga dita e nesërme. **Duket se nuk ngurroni të aktivizoni të rinjtë.**

Unë personalisht e kam natyrën që kam dëshirë të punoj me djem të rinj, sepse një 20-vjeçar nuk është shumë i ri. Duhet të thyejmë këtë tabu që 20-vjeçarëve t'u besojmë më tepër. Janë emra të rinj, unë kam marrë edhe nga ekipi i dytë dhe i të rinjve, vazhdimisht në stërvitje afro 5-6 lojtarë që të stërviten me të rinjtë. I përdor në ndeshje në situata të ndryshme e nëse më jep besim, nuk kam asnjë problem nga mosha për ta aktivizuar.

A është aktivizimi i tyre një filozofi e klubit?

Partizani është një stemë e madhe, bluze e madhe dhe ideja për të afruar 20-vjeçarët nuk është për t'i rënduar, por për t'i dhënë mundësinë për të krijuar një ide mbi bluzën dhe klubin. Në një kohë të shkurtër, ka

vetëm dy muaj, nuk e kam të mundur që të gjithë të jenë të barabartë në fushë, por të paktën të trajtohen njëjloj. Të jetë mundësia, siç na është dhënë në kohën tonë, kur kemi luajtur në futboll. Ka një grup të madh që është premtues, ndaj është edhe arsyeja që i kamë afruar në ekip, sepse janë të tillë. Për të parë sforcën e një titullari dhe zënë vendin në formacion është një kohë e gjatë, por megjithatë dera është e hapur për të gjithë, do t'i presim deri në fund. Ky është një klub, edhe në anën financiare do që të rinjve të rritet dhe të merret investimi mbrapsht. Është një filliz i ri, të cilin nuk mund ta realizojmë menjëherë.

Kjo do të jetë edhe ndeshja e parë në shtëpi me tifozë në këtë sezon.

Për ne është gjë e madhe që kthehen tifozët. Kemi disa ndeshje pa ata. Partizani nga natyra është i lidhur ngushtë me tifozët, është shtytje e

SUPERLIGA		
Të premtën		
Partizani - Flamurtari	19:45	
Të shtunën		
Luftëtari - Teuta	15:45	
Skënderbeu - Tirana	18:45	
Të dielën		
Kastrioti - Laçi	5:45	
Kukësi - Kamza	8:45	
RENDITJA		
SKUADRA	N	P
SKËNDERBEU	4	10
KUKËSI	4	7
PARTIZANI	4	7
FLAMURTARI	4	7
LAÇI	4	6
KAMZA	4	6
TEUTA	4	5
TIRANA	4	4
KASTRIOTI	4	3
LUFTËTARI	4	0



Vlonjatët vijmë në kryeqytet pa Allën dhe Hyosenin

Trajneri Ilir Daja as këtë javë nuk do ta ketë të plotë skuadrën. Për momentin, dy mungesa të sigurta ka Flamurtari për transfertën e sotme me Partizanin. Mbrojtësi Albi Alla ende nuk është rehabilituar dhe kjo konsiderohet si një mungesë me peshë në radhët e vlonjatëve, pasi në këtë pozicion ata patën mangësi në ndeshjen e fundit me Skënderbeun. Sipas stafit, mbrojtësi Alla mund të jetë gati vetëm pas ndeshjes me Partizanin. Mungesë është edhe Alesio Hyoseni, që u dëmtua rëndë në ndeshjen me Skënderbeun. Pas një dëmtimi nga loja e rëndë e lojtarëve të Skënderbeut, Hyoseni përfundoi në spital, pasi mori një çarje të konsiderueshme në kërcirin e këmbës. Lojtari nuk ka nisur përgatitjet me grupin, kështu që nuk ka shansë që të jetë në formacion për sfidën e sotme.

madhe për ne, është nxitje. Do të shërbejë për të na karikuar që t'i kënaqim ata, shpresoj që t'ia arrijmë.

Objektivi i radhës?

Unë besoj se çdo ndeshje nëse humbet, automatikisht krijohet një presion, një alarm i vogël, varet se sa një klub është në gjendje ta mbajë e menaxhojë. Nga ana e klubit bashkëpunimi është i ngushtë dhe mbahet një presion i vogël. Për ne është ndeshje vendimtare, pasi është kundër Flamurtarit. Është një ndeshje që vjen pas një barazimi, nuk duhet të shikëputemi nga vendet e para dhe duhet të jemi me këtë fokus, vetëm te Flamurtari, pastaj pas dy javësh është një ndeshje e atmosferë tjetër: Do të kërkojmë që pas kësaj ndeshjeje të jemi 100.

SULMUESI ARGJENTINAS

Ikardi i vë kushte Interit, kërkon 10 milionë euro në vit


Për vazhdimin e bashkëpunimit mes Interit dhe sulmuesit Mauro Ikardi, situata është e paqartë dhe tifozët zikaltër duhet të presin për të mësuar se çfarë do të ndodhë konkretisht. Sipas asaj që raporton "Sportmediaset", palët janë ende larg. Kapitani i Interit ka kushtet e tij për rinovimin. Ai kërkon të përfitojë një rrogë të lartë, me shifra si ato që i janë propozuar gjatë merkatos së fundit nga klube të tjera, që vazhdojnë të kenë interes për të. Fjala është për klube si Real i Madridit, PSG dhe Juventusit, që i kanë propozuar argjentinasit deri në 10 milionë euro. Kështu, Interi jo vetëm duhet të veprojë shpejt, por edhe duhet të ngjitet në këtë nivel page, nëse dëshiron të mbajë sulmuesin dhe kapitenin në skuadër edhe në të ardhmen.

GRACIANO ÇEZARI

Ish-gjyqtari: Nëse do ishte i Realit, Bryzh s'do e ndëshkonte Ronaldo

Graciano Çezari, ish-arbitri i njohur italian, ka folur për episodin e ndëshkimit me karton të kuq të Kristiano Ronaldos gjatë ndeshjes me Valencian. Duke folur për "Sportmediaset", Çezari theksoi se nuk do të kishte ndodhur e njëjta gjë, nëse portugezi do të ishte ende pjesë e Realit të Madridit: "Nëse Ronaldo do të ishte me fanellën e Realit të Madridit në atë ndeshje, nuk do të ishte ndëshkuar me karton të kuq. Është psikologjike në Europë kur gjykon Realin dhe CR7, nëse ky episod do t'i ndodhte në 'Santiago Bernabeu', nuk do të kishte marrë atë dënim", - u shpreh ish-arbitri italian. Ndëshkimi i Kristiano Ronaldos me karton të kuq në ndeshjen Valencia-Juventus nga gjermani Feliks Bryzh ka sjellë shumë polemika. Shumë e konsiderojnë një ndëshkim të ekzagjeruar për këtë futbollist tani që është pjesë e Juventusit, ndërsa te Real ai ishte "imun".

Fjalëkryqi (1)



- 37. Power, ish- e Al Bano-s.
- 39. Muhammad i ringut.
- 41. Në fillim të vitit.
- 42. Eshhtë grindje
- 46. Janë centralet si Chernobyl.
- 50. Thurin prapaskena
- 51. Të fundit në tender.

VERTIKAL

- 1. Eshhtë edhe ajo e Mendelejevit.
- 2. Një erë kafeje.
- 3. Fillojnë tinëz.
- 4. Mbahet në polifoni
- 6. Eshhtë më e vogël se bashkia një e tillë.
- 7. Të parat në orkestër.
- 8. Gibson aktor.
- 9. Eshhtë festive në festë.
- 11. Eshhtë si biskotë.
- 12. Shpërthejnë më polemika.

HORIZONTAL

- 1. Eshhtë detyrim që paguhet.
- 5. Ende eshtë ndryshe.
- 10. Skuadër greke.
- 11. Agjenci Doganore Sarandë.
- 14. Duken të gjata në pritje.
- 15. Derek aktore.
- 16. Janë në modë.
- 18. Pak mefistoflike.
- 19. Inicialet e Mallë regjisor.
- 20. Ente Monitruuese Durrës.
- 22. Eshhtë e çuditura.
- 26. Në mes të Tommy dhe Jones aktor.
- 27. El Pibe de oro.
- 28. Janë punëtorë... marksistë.
- 30. Eshhtë cilësi.
- 31. Fillojnë ceremoninë.
- 32. Ngryesm me vërejtje.
- 33. E kundërta e zenitit
- 36. Eshhtë poetik ai i poetit.



Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- 1. Hasi ish mesfushor.
- 5. Rrënoqethet nga frikat.
- 9. Fillojnë poshtë.
- 10. Janë në guvë.
- 12. Një hektar i shkurtër.
- 13. Një pesk i rëndë.
- 14. Një dog që hahet.
- 15. Qyteti i Scavolini-t.
- 18. Gjysmë fetare.
- 19. Janë regjimet dikaktoriale.
- 22. Fise pa fe.
- 23. Janë këngët me iso
- 24. Shkaktajnë avari me punë armisore.
- 26. Fillojnë panikun.
- 27. Ishin ushtarët e Pirros.
- 28. Eshhtë filozofi e moralit.
- 30. Filloko aktor.
- 31. Rrallë eshtë përgjysmë.

VERTIKAL

- 33. Një çrnim i synuar nga kineastët.
- 37. Ishte popull i tellallit
- 39. Nuk qeshin.
- 42. Nuk ka amoma një bebe
- 43. Janë poezi.
- 44. Një mbishkrim në kryq.
- 46. Fillojnë një temë.
- 47. Lidhen të parat.
- 48. Eshhtë inoranjta e... akuzuar.



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

P A P A S S K U L V E
 A R A D M I N A T E G
 R A E D I S O N E B R O
 A R A T N T A S M A N
 F A I K O P E R T I N E
 I T M A T E R I A L E S
 N P A R A R E N D E S I T
 A A R T U R A I A V A
 E C H I A R A T U L E T
 O A A I U S M J E T I
 C L I N T L U L I T E K
 K A P A C I T E T R O M E
 P E R V E N D I M E T
 A Z O V D A D I L E M A
 K O M E D I M I L A N E Z
 P E R I O D I R E T E
 T I T S A M A R T A N E
 T K A M E R A M A N E V
 E R C A D S I N T E Z A
 G A L E N I T A S A R
 L U A T B I E R O N I
 L U I G I E R E N D E T
 L A K E M A R A I S E T
 A R E N A N E M O T E R E

FJALËKRYQI (2)

A R G E T I M
 I L O Z O F I K
 A R G E T I M
 I L O Z O F I K
 T H E N I E
 T E M E N Ç U R A

SUDOK

		1					8 3		
			7					6	
					1				
				8					
2 7			5 9 4						
4	6				2 7				
1							2 6		
		9 3						8	
6		4					1 5		

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

7 6 1	8 3 2	4 9 5
5 8 9	4 1 7	2 6 3
2 3 4	5 6 9	7 8 1
4 2 6	1 7 8	5 3 9
3 5 7	2 9 6	1 4 8
9 1 8	3 4 5	6 7 2
6 4 2	9 8 1	3 5 7
8 7 5	6 2 3	9 1 4
1 9 3	7 5 4	8 2 6

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

B	P	K	E	T	A	H	A	M		
G	O	D	A	R	D	R	R	E	Z	E
O	R	E	G	O	N	S	T	N	I	T
L	P	A	L	L	A	T	E	T		A
I	R	O	N		Z	E	R	I	E	L
A	Z	E	T	A	M	I	L	E	T	I
T	I	T	R	K	A	A	S	I	K	
H	S	T	A	R	A	B	T	E	K	E
I	H	A	D	A	B	M	O	N	E	T
I	R	I	N	I	S	S	I	T		
A	R	G	A	T	N	A	T	N	A	P
P	A	T	A	R	A	D	H	E	T	A

Argëtimit filozofik

- Frika, ndryshe nga të gjitha mëkatet e tjera, e bën një njeri të mendojë më të mirën për të tjerët, dhe më të keqen për veten e tij.

- "Lumturia nuk eshtë mungesa e problemeve. Eshhtë aftësia jonë për t'i përballuar." Steve Maraboli

- Ka dy tragjedi në jetë: Njëra eshtë dëshimi për të përbushur dëshiratona. Tjetra eshtë përbushja e të gjitha dëshirave tona.

Thënie të mëncura

- Edhe pse askush nuk mund të kthehet prapa dhe të bëjë një fillim të ri, kushdo mund të fillojë nga tani dhe të japë një fund të ri. Carl Bard
- Kujdes kur ndihmoni dikë. Kufiri midis të jeni të dobishëm dhe të jeni të përdorur, eshtë shpesh i padukshëm. Albert Einstein
- Gjëra të thjeshta nuk kanë ndryshuar, eshtë gjithmonë më mirë të jesh i sigurtë dhe i vërtetë. Për të bërë më të mirën me ato që keni.
- Të jeni të gëzuar me kënaqësitë e thjeshta. Dhe të keni kurajo kur gjërat shkojnë keq. Laura Ingalls Wilder

